

Emri
"Gornamakedonia", e ngjitur apo e ndarë?

Fq.3



VAZHDOJNË REAGIMET

Rasti i Almerit, çelësi te Jovevski

Fq.6




Patriotizmi modern
Arben Taravari

Fq.11

Koha

www.koha.mk



KOHA për enigma

Fq. 12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3325 · e shtunë/e diel 24-25 mars, 2018

2c | 7°c

15 DEN

FORUM

**Çanakale/
Galipoli**



Kush nga gjeneratat që kanë jetuar në sistemin e kaluar nuk e ka dëgjuar këngën "Çanakale" të Hashim Shalës e Tahir Drenicës. "Çanakale mrena u nisa prej Stambollit...". Ajo këngë që e kam dëgjuar si nxënës "në kohën e gramofonëve", më kishte shtyrë të pyes veten përse rapsodët shqiptarë t'i këndojnë Çanakalësë. Nuk më kujtohet ta kishim mësuar në lëndën e historisë në kontekst të Luftës së Parë Botërore, se kur kishte ndodhur beteja e Çanakalësë. Në mbamendjen e dëgjuesit jo fort të arsimuar, sigurisht ishte fiksuar një betejë përgjakshme, atje diku

Fq.10

RAJON

**Arratiset
tregtari i
mishit të
prishur**

Fq.17

EDITORIAL

**24 mars 1999,
këtu Aviano!**

Fq.14



GJETJETË REJA PËR MINËN NË SOPOT (II)

DSK-ja "HESHTI" USHTRINË

E vërteta mbi fajtorët e vërtetë të rastit të Sopotit është fshehur në një raport të Shërbimit sekret të ARM-së. Aty janë përshkruar të gjitha detajet e kësaj ngjarje, mirëpo ka qenë insistimi me çdo kusht i DSK-së që hetimeve t'u jepet drejtim tjetër, ndërsa fajtorët e vërtetë të shpëtojnë duke ikur nga Maqedonia

EKSKLUZIVE

Fq.5

Muzeu i Alfabetit, pa historian e gjuhëtar

Shkup, 23 mars - Me gjithsej gjashtë të punësuar, Muzeu i Alfabetit në Manastir funksionon me mangësi të theksuara kadrovike. Pa historian dhe gjuhëtar, ky muze renditet ndër institucionet e rralla nacionale në vend që nuk i posedon kushtet minimale për zhvillimin normal të punës. Drejtori aktual, si ish historiani i vetëm i punësuar në këtë muze, vazhdon të luajë këtë rol në mungesë të një zëvendësuesi.

I pazëvendësuar ka mbetur edhe vendi i gjuhëtares së vetme në këtë muze, që u nda nga jeta disa muaj më parë. Sipas drejtorit Nuer Arslani, investimi më i mirë për muzeun janë punësimet dhe kompletim i tij me staf të specializuar, nëse presim që muzeu të jetë në nivelin e të gjitha institucioneve të tjera nacionale. Një situatë dhe probleme të ngjashme janë trashëguar prej gati dhjetë vitesh, madje...

Fq.7



EDITORIAL

24 MARS 1999,
KËTU AVIANO!

Emin AZEMI

Më 24 mars 1999, Avianoja ishte bërë baza më e përfolur ushtarake e NATO-s, prej ku u nis karvani i gjatë i shpëtimit. Ulërima e bisha-ve karpatische me fytyrë njeriu kishte prishur gjumin e fëmijëve të Kosovës, por avionët e NATO-s po sillnin ninulla nga ajri, kurse nga toka vinte morali i pandërprerë diplomatik ndërkombëtar dhe marshi ushtarak i UÇK-së. Populli martir i Kosovës po e përjetonte mrekullinë e një kthese që po e fuste kohën në parametra të pakrahasueshëm me historitë e vuajtjeve dhe golgotave individuale e kolektive.

Por në krejt këtë rrëfim ishte një protagonist që i dha kujtesës sonë konturat e pashlyera të mbamendjes. Ai ishte Presidenti amerikan, Bill Clinton, fryma dhe fjala e të cilit ato ditë marsi kombinoreshin për të shqiptuar zëshëm apelin e njeriut që e kupton thirrjen e tjetrit kur e ka më së keqi.

Aksioni i NATO-s para 20 vjetëve e shndërroi letargjinë e mosveprimit kolektiv në kauzë sublime humane. Kosova kishte vite që po vuante përmasat shqetësuese të politikës genocidale të Beogradit dhe për pasojë rezultoi në një rezistencë të armatosur të shqiptarëve. Por, ajo që atëherë konsiderohej e pamundur, sot mësohet si histori. Për herë të parë në histori u takuan në një pikë solidariteti ndërkombëtar i udhëhequr nga SHBA dhe disa shtete evropiane, me aspiratën liridashëse të një populli.

“Është një rrugë në të cilën duhet të shkojë bota në shekullin 21. Mësimi është i njëjtë, fuqia e shembullit tuaj mbetet e njëjtë. Duhet të jeni shumë krenarë për atë që keni arritur dhe unë i thashë presidentit dhe kryeministrit se e keni bërë punën shumë më mirë se sa kanë menduar të tjerët. Keni konsoliduar institucionet demokratike, keni nxitur shtypin e lirë dhe shoqërinë civile. Edhe shumë vende të tjera do pasojnë pavarësinë tuaj, jeni pjesë e FMN-së dhe shumë shpejt do jeni edhe pjesë e NATO-s e BE-së. E keni kërkuar sigurinë tuaj në vendin tuaj dhe keni ndërmarrë hapet e duhur”.

Këto fjalë i tha në Prishtinë Presidenti Clinton, me rastin e inaugurimit të një bulevardit me emrin e tij para disa viteve. Bill Clintoni erdhi sërish në Prishtinë për t'ua përcjellë mesazhin shqiptarëve të Kosovës se Amerika vazhdon të jetë pranë e tyre, kurse shtatorja e ngritur për nder të tij, do të jetë një simbol që ua përkujton shqiptarëve njeriun që e ndryshoi rrjedhën e historisë.

Kosova dhe gjithë shqiptarët kanë arsye të jenë përkushtues ndaj Amerikës dhe nuk është vetëm rasti i fundit kur ky shtet i fuqishëm udhëhoqi aleancën perëndimore për të shpëtuar një popull të tërë nga shfarosja dhe gjenocidi. Përkushtimi shqiptar kundrejt Amerikës është shndërruar tashmë në një doktrinë shpirtërore disadekëshe dhe “ëndrra amerikane” për shqiptarët është modeli më i kapshëm i luftës për liri e pavarësi. Mbase, jo rastësisht edhe Rilindësi ynë, Mjeda, në poemthin e tij “Liria” me mjeshtri dhe vizion kishte ditur ta skicojë tablon amerikane si një fushë ku të gjithë popujt e robëruar mund të gjejnë frymëzim për përpjekjet e tyre liridashëse.

Duhet të jemi krenarë që po jetojmë në epokën e Bill Clintonit, aq më tepër kur ishim edhe dëshmitarë të gjallë të një kohe, e cila me siguri do të ishte ndryshe, po të mos ishte Presidenti Clinton. Roli dhe konteksti i veprimit të kësaj figure të fuqishme politike ndërkombëtare, duhet të shërbejë si udhërrëfyes për moralin e politikanëve të cilët në momente të caktuara duhet të nxjerrin vendime largpamëse. Largpamësia e Bill Clintonit pati dy efekte në politikën ndërkombëtare: e tregoi në dritë të vërtetë drejtësinë e politikës së jashtme amerikane dhe e arsyetoi në praktikë besueshmërinë e një populli kundrejt një shteti, i cili në vazhdimësi i mban premtimet dhe fjalën e dhënë nuk e shkel me asnjë çmim.

Burrat që e krijuan Amerikën, dinë si ta bëjnë atë edhe joshëse për të tjerët. Bill Clinton është një nga ata që Amerikën na e sjell më afër zemrave tona. Ai është heroi që na bën të turpërohem nga vetëbëgenisja.

Demarkacionit, një turp i madh

“Aprovimi i demarkacionit është një turp i madh për gjithkënd që e ka votuar. Tradhtar nuk lindesh por bëhesh me një veprim: kova mbetet kovë, dhe ka bartur ujë për ty por kur ka një vrimë në fund e hedh se nuk mban me ujë dhe nuk të kryen punë. Edhe politikanët që shiten, blihen dhe korruptohen janë kova të shpuara. Meritat, çka do që të jenë, kanë vlerë sa ke integritet dhe besnikëri ndaj kombit dhe shtetit”, ka shkruar prof. Shenasi Rama në profilin e tij në FB.



Popull groshë

“Mirë që ndalon makinën gati në gjysmë të rrugës, pa bllokazh, zbrit gjithë tangarllëk dhe niset për te dyqani i cigareve. Pasi sheh vargun e makinave që presin, e shton edhe më tangarllëkun. Merr paketën, jep paratë, merr kusurin, hap paketën, nxjerr një cigare, e kalon mes buzëve, e lag, e vë në buzë, rrëmon nëpër xhepa për çakmakun, ndez cigaren dhe me tangarllëkun e groshës në tajare, niset drejt makinës së tij. I hedh një sy targës, afrohet te pasqyra, rregullon pak baluket, u jep një shikim makinave në rradhë, dhe ia fut gazit në maksimum...”

Nuk mbeti njeri pa e fiksuar makinën e bukur e të re me targa 888.

O ju shpëlaftë lumi, ju shpëlaftë. S'bëhemi njerëz ne, populli i groshës, jo”, shkruan në profilin e tij në FB, gazetari nga Tirana, Urim Bajrami.

Skandal ne Facebook!

“50 milionë profile te FB janë analizuar pa marre lejen e perdoruesve amerikane nga firma Cambridge Analytica, pak rendesi ka nese kane sherbyer per fushaten e Trumpit. Firma thote se i ka perdorur per nje studim shkencor, por nje reporter undercover ka zbuluar gjithçka. Pyetja qe shtrohet eshte a ka nevojë FB dhe rrjetet sociale per nje kuader rregullues? Ndersa dikur u pershendeten si rrjete demokratizuese te shoqerise, sot perhere e me teper rrjetet sociale po e tregojne veten si keqperdoruese te besimit tone te hershem.

Ne fillim të vitit 2018 Zuckerberg tha se do ta shfrytëzonte këtë vit për të “riparuar” disa probleme të medha. Le të mbrojmë më mirë “keqperdorimin” e pjesetareve të rrjetit të tij dhe të rrisë sigurinë. Menjeherë pas skandalit në Amerikë, ka reaguar komisioneri evropian për mbrojtjen e të dhenave personale Giovanni Buttarelli që ka kërkuar zgjidhje ndërkombëtare në problem të FB sepse informacionet personale nuk mund të perdoren për manipulim. Orteku pritet të vazhdojë. Edhe në Gjermani kerkohen vazhdimisht rregulla me te forta per rrjetet sociale. Ndryshe nga gjermanet qe jane shume konservatore ne mbrojtjen e te dhenave personale, ne shqiptaret kemi nje gje te perbashket me amerikanet: Nuk u besojme politikeve, por u besojme symbyllurazi rrjeteve sociale ku shpalosim me liber shtepie gjithe jeten tone. Sa per mbrojtjen e informacioneve personale, as qe e njohim si concept. Mbase ne nuk e kemi luksin te merremi me keto tema. Por ama kur sheh rrjetet sociale, kur sheh komentet e platformave online si jane mbushur me militante partish qe pergjigjen ne te qindten e sekondes me fjali te gatshme si “bresheri automatiku” ne mbrojtje te logos qe u jep buke, - kupton qe sot ka pak gazetarë, dhe me shume “kamikaze” profesioniste qe paguhen per te baltosur kundërshtarin. Kjo nje amatori te medias online mund t'i krijojë pershtypjen e lirisë se shprehjes dhe te mendimit ne nje vend demokratik. Por vend demokratik pa rregulla nuk ka, ne jemi thjesht si hani pa porta. Dhe per sa kohe vete media tradicionale online eshte me teper ne rolin e thashethemepërhapës se sa te analizuesit te dites, jo te dhenat tona personale te shiten ne shtet, e ne FB, por edhe ne te na shesin e te na blejne me gjithe lecka, nuk do e hape njeri gojen!, shkruan në profilin e saj në publicistja nga Tirana, Jonila Godole

MEDIACitate

Çka nëse shqiptarët nuk duan të jetojnë në Maqedoni?



“Presidenti refuzon ta nënshkruaj dekreten e Ligjit të gjuhëve, me çka po e bllokoi rrugën e Maqedonisë multietnike, zgjidhje kjo e vetme politike për ekzistencën e shtetit. Dhe në vend se të flet për atë se si këto të drejta gjuhësore do të zgjerohen edhe për komunitetet tjera etnike, politikë kjo që do ta zbuste tehun e përplasjeve shqiptaro-maqedonase, ai po përpjetet ta kthej rrotën e historisë prapa. Duke ikur nga ballafaqimi me realitetin se vetëm me barazi të plotë mund të “mbahen” shqiptarët në Maqedoni dhe të fitohet lojaliteti i tyre ndaj shtetit të Maqedonisë, kryetari dhe opozita dhe një grup mbështetësish maqedonas bëjnë akrobacione të rrezikshme kushtetuese dhe ligjore. Të rrezikshme, sepse mund të shkaktojnë konflikt të panevojshëm ndëretnik. Me dy shtete shqiptare në kufijtë e Maqedonisë, me rrugëtregues te Struga ku shkruan “Tirana –136 km” dhe “Shkupi –176 km”, ndjenja e lojalitetit duhet të meritohet me lojalitetin e shtetit ndaj shqiptarëve. Nga përvoja me federatën jugosllave e kemi pa se çka ndodhë kur përfaqësuesit e një kombi do të deklarohen se nuk duan më të qëndrojnë në shtetin e përbashkët. Prandaj, ja një pyetje hipotetike: Çka do të ndodhte nëse shqiptarët deklarohen se nuk duan më të mbeten në shtetin e përbashkët. Nuk lejohet ndryshimi i kufinjëve në Europë, do të thoshte dikush. Po, por nuk është e lejueshme edhe me forcë të mbashë dikënd nëse don të ikë.Unë nuk di për ndonjë kryeministër të mëparshëm dhe për president aktual dhe ndonjë parti tjetër në pushtet, nga republikat e mëparshme jugosllave, përpos Millosheviqit dhe partinë e tij, të kenë patur aq shumë jopopullorë tek aletatët tanë. Fakti se Perëndimi, në masë të duhur, nuk i kritikonte publikisht, kishte të bënte me dy çështje: e para, nuk llogarisin në shtet aleat të cilit duhet “blerë kohë” për ta tejkaluar sëmundjen fëmijërore të çdo demokracie dhe e dyta - kryesisht, përpos neve vet, askujt tjetër nuk mund t'i shkaktojme dëm”. ...Gjithnjë më ngjan në shkuarje në fushë për të korrur sërish nacionalizëm. Megjithatë, po luajtën në kartën e nacionalizmit maqedonas, shumë vështirë për ne. por edhe për ta”. (Denko Maleski, Fokus, 23 mars)

NËSE NUK E KENI DITUR...

A KA PASUR TRADITATË ARGJENDARISË NË SHQIPËRI?

Traditat e argjendarisë janë mjaft të hershme në truallin e Shqipërisë. Objektet arkeologjike prej bronzi, ari dhe argjendi, që i përkasin qytetërimit ilir e mesjetës së hershme shqiptare, tregojnë për zhvillimin e argjendarisë dhe nivelin e lartë artistik të saj. Lulëzimin më të madh e arriti në



shek.XVIII deri në mesin e shek.XIX. Pas kësaj periudhe kërkesat për prodhimet e argjendarisë vijnë gjithnjë duke u pakësuar. Si pasojë dhe mjeshtëria shkoi drejt rënies. Qendra të njohura për zhvillimin e argjendarisë qenë: Shkodra, Elbasani, Berati, Gjakova, Prizreni etj.

Të njëjtat burime diplomatike që referuan për gazetën KOHA dy muaj më parë thonë se në takimin e radhës në Vienë, me prezencë edhe të ndërmjetësuesit Metju Nimiz, do të bisedohet për kompromis të mundshëm të palës greke që të lëshojë pe siç po kërkon pala maqedonase që emri "Gornamakedonia" të mos jetë kompozitë e ngjitur dhe që të përkthehet në gjuhë tjera jashtë vendit si në organizata ndërkombëtare ashtu dhe marrëdhëniet bilaterale.

ÇKA DOLI NGA VALIXHJA DIPLOMATIKE KOTZIASIT NË SHKUP



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 23 mars - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikola Dimitrov dhe homologu i tij grek Nikos Kotzias, të premten në Shkup dhanë porosi dhe sinjale për një zgjidhje të pranueshme për emrin e shtetit. Nga ajo që u pa gjatë Konferencës së përbashkët për shtyp, jo vetëm se u afishua emri "Gornamakedonia", (në shqip "Maqedoniaepërme"), por nga komoditeti i dy ministrave të Jashtëm lihej të kuptohej se palët tashmë mund të jenë marrë vesh definitivisht për të njëjtin emër, për të cilin gazeta KOHA pati raportuar dy muaj më parë, referuar burimeve anonime diplomatike në vend. Të njëjtat burime diplomatike, në kohën kur palët deklarohen se janë afër të gjejnë zgjidhje të pranueshme, theksojnë se në takimin e radhës në Vienë me prezencë edhe të ndërmjetësuesit Metju Nimiz, do të bisedohet për kompromis të mundshëm të palës greke që të lëshojë pe siç po kërkon pala maqedonase që emri "Gornamakedonia" të mos jetë kompozitë e ngjitur dhe që të përkthehet në gjuhë tjera jashtë vendit si në OKB, NATO BE dhe organizata dhe organizma tjerë ndërkombëtar, po ashtu dhe në marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe shteteve tjera. Sipas këtyre burimeve, me interes do të pritet qëndrimi BE –së dhe SHBA-së, nëse do të ndihmojë Maqedoninë, që duke shfrytëzuar të dy partitë me ideologji të majtë që janë në pushtet, që të kapërcej pengesën kryesore për të qenë pjesë e NATO në Samitin e radhës në korrik dhe të hapë negociata për hyrje në Bashkimin Evropian.

ZGJIDHJE QË NUK ENËNÇMON ASKËND

Gjasat janë që të gjendet kompromis në favor të Maqedonisë, referojnë burimet anonime për Gazetën KOHA. "Duhet të gjejnë zgjidhje që nuk e nënçmon askënd dhe do të hap dyert e së ardhmes", theksoi Dimitrov gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me diplomatin grek Kotcijas. Nikolla Dimitrov shtoi se ka pasur bisedime të mira ku ka dominuar çështja rreth dallimeve për emrin dhe për ndërtimin e marrëdhënieve në të ardhmen. Sipas tij është në interes të përbashkët që të gjendet zgjidhja e këtij problemi disaveçar. Dimitrov përjashtoi mundësinë që zgjidhja e kontestit të

jetë një emër i ngjitur siç përmendi propozimin "Gornamakedonia". Emër i përngjitur me përcaktim gjeografik, i cili do të jetë i bashkuar dhe në vetvete do ta përmbajë emrin Maqedoni, nëse shqiptohet shpejt mund të ndodh të mos dëgjohet fjala Maqedoni, porositi shefi i diplomacisë së Maqedonisë.

"Referenca e tanishme Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e përmban emrin Republika e Maqedonisë dhe është përkthyer në gjuhë zyrtare në KB. E kam të vështirë t'ia them popullit tim se një emër i përbërë me ndonjë përcaktim, së bashku me emrin Maqedoni, në një fjalë të vetme, është një zgjidhje e mirë", deklaroi Dimitrov.

KOXIAS: JEMI PËR TI ZGJIDHUR PROBLEMET, QË NUK I KRIJUAM NE, POR I GJETËM

Shefi i diplomacisë greke në pyetjen se pse Greqia insiston në ndryshim të Kushtetutës të Maqedonisë, tha se sipas praktikës të gjykatave kushtetuese evropiane kushtetutat kombëtare janë mbi të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare. "Prandaj është e nevojshme të qartësohet kjo çështje, por kjo për

momentin nuk është temë, sepse jemi në mes të procesit të negociatave", tha Koxias. Ai njëherësh tha se është për një zgjidhje të ndershme, të drejtë dhe të saktë, që merr parasysh pikat kryesore dhe interesat e të dyja palëve që po locohen përmes negociatave. "Sot kemi bërë hapa për të zgjidhur problemet, që nuk i krijuam ne, por i gjetëm. Jemi të obliguar që ti zgjidhim dhe kjo do të ndihmojë për miqësinë midis dy popujve për stabilitetin dhe sigurinë, si dhe për zhvillimin e të dyja shteteve dhe tërë rajonit. Pengesat politike patjetër të tejkalohen dhe kjo do të sjell zhvillim në të ardhmen. Falënderoj z. Zaev që të kemi një diskutim të tillë, falënderoj Ahmetin, Xhaferin, Mickoskin...Greqia dëshiron një kompromis që është interes i përbashkët në të ardhmen", theksoi Koxias.

Duke folur për draft – marrëveshjet e Athinës dhe Shkupit si dhe atë të ndërmjetësit Metju Nimiz, ministri Kotzias theksoi se dokumentet kanë si qëllim ti harmonizojnë pozicionet dhe propozimet e palëve që në fund do të rezultojnë në një tekst. "Në fund duhet të kemi një tekst që ndërmjetësi Methju Ni-

mici do ta shndërrojë në marrëveshje dhe do t'ia dorëzojë Këshillit të Sigurimit të KB-së, si vërtetim se problemi është zgjidhur", sqaroi shefi i diplomacisë greke. Dimitrov nga ana tjetër theksoi se Maqedonia angazhohet për zgjidhje të qëndrueshme e cila do të arrihet dhe pranohet nga opinioni dhe qytetarët e të dyja vendeve. Dy ministrat kanë përmendur takimin e radhës në Vjenë me ndërmjetësin Nimetz ku do të vijojnë përpjekjet për zgjidhjen e kontestit. Kotzias më pas ka vijuar me takimet me kryeministrin Zoran Zaev, kryeparlamentarin Talat Xhaferi, kryetarin e VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski dhe kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti. Kryeministri Zoran Zaev theksoi se ky takim është i rëndësishëm në bisedimet për problemin që Republika e Greqisë e ka me emrin kushtetues të Maqedonisë, dhe se i njëjti realizohet në një moment pozitiv kur priten zgjidhje afatgjate për çështjet bilaterale në rajon, për perspektivat dhe pritjet e Bashkimit Evropian. "Fokusi i bisedimeve tona patjetër duhet të jetë ardhmëria e dy vendeve. Duhet që të jemi të vendosur, dhe të bëjmë hapa të cilat do të dërgojnë më afër

zgjidhjes së çështjes së vetme të hapur mes dy vendeve tona. Jam i sigurt se kjo qasje do të sjell deri në zgjidhje e cila do t'u japë argumente të pranueshme institucioneve të të dyja vendeve, por edhe opozitës, që të pranojë se ajo do të jetë e dinjitetshme edhe për Republikën e Maqedonisë, por edhe për Republikën e Greqisë", tha kryeministri Zaev, në takim me Koxiasin.

Zaev theksoi se edhe më tej i përmirësojmë marrëdhëniet bilaterale dhe të njëjtat do të bëhen më të mira, pasi që të zgjidhet çështja e emrit, pasi që siç ka deklaruar Zaev, qytetarët e të dyja vendeve, miqtë tanë të BE-së dhe komuniteti ndërkombëtar presin zgjidhje për këtë çështje", deklaroi Zaev. Ministri Koxias, sipas Qeverisë së Maqedonisë ka theksuar se e tanishmja dhe e ardhmja kërkojnë përgjegjësi për zgjidhjen e çështjeve të hapura. Ministri Koxias ka theksuar se Greqia, edhe pse është anëtare në NATO dhe BE me traditë më të madhe në rajon, ka përgjegjësi të madhe për zgjidhjen e kësaj çështje, dhe patjetër duhet që të gjendet kompromis i pranueshëm për të dyja palët.

ZAEV: NJË ZGJIDHJE E DINJITETSHME PËR TË DY VENDET

"Fokusi i bisedimeve tona patjetër duhet të jetë ardhmëria e dy vendeve. Duhet që të jemi të vendosur, dhe të bëjmë hapa të cilat do të dërgojnë më afër zgjidhjes së çështjes së vetme të hapur mes dy vendeve tona. Jam i sigurt se kjo qasje do të sjell deri në zgjidhje e cila do t'u japë argumente të pranueshme institucioneve të të dyja vendeve, por edhe opozitës, që të pranojë se ajo do të jetë e dinjitetshme edhe për Republikën e Maqedonisë, por edhe për Republikën e Greqisë", tha kryeministri Zaev, në takim me Koxiasin.

KOTXIAS: PENGESAT POLITIKE PATJETËR TË TEJKALOHEM

"Sot kemi bërë hapa për të zgjidhur problemet, që nuk i krijuam ne, por i gjetëm. Jemi të obliguar që ti zgjidhim dhe kjo do të ndihmojë për miqësinë midis dy popujve për stabilitetin dhe sigurinë, si dhe për zhvillimin e të dyja shteteve dhe tërë rajonit. Pengesat politike patjetër të tejkalohen dhe kjo do të sjell zhvillim në të ardhmen. Falënderoj z. Zaev që të kemi një diskutim të tillë, falënderoj Ahmetin, Xhaferin, Mickoskin...Greqia dëshiron një kompromis që është interes i përbashkët në të ardhmen", theksoi Koxias.

"GORNAMAKEDONIA", E NGJITUR APO E NDARË?

Paguhen më shumë se 78 milionë euro subvencione

Shkup, 23 mars - Më shumë se 78 milionë euro janë paguar nga Programi për mbështetje financiare në bujqësi. Më shumë se gjysma e Programit për vitin 2017 është realizuar. Këtë e kumtoi Nikollçe Babovski, u.d. drejtor i Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Ai shpjegoi se është e vogël për qindja e subvencioneve të mbetura ose minimale.

"Bëhet fjalë për persona të cilët kanë dorëzuar kërkesë, u është aprovuar kërkesa për subvencionim, por ende nuk kanë nënshkruar në pajtueshmëri për rentabilitet ndaj institucioneve të caktuara për të cilët jemi kompetentë ne që ta bëjmë. Më së shpeshti ajo është blerja e tokës ndaj SHA Ujësllësi ose Ndërmarrja publike për ekonomizim me kullota. Dhe në qoftë se personi ka vdekur, derisa trashëguesit e kryejnë procedurën e trashëgimisë ose kanë dorëzuar llogari transaksioni të cilat janë shuar dhe duhet sërish të na i dërgojnë të reja", shpjegoi Babovski. Në pyetjen e gazetarëve për importin e mishit, Babovski tha se nuk kanë ingerencë në këtë sferë dhe shtoi se këtë e udhëheq Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (AUV).

Paga mesatare 24.025 denarë

Shkup, 23 mars - Neto paga mesatare e paguar mujore për të punësuar në Maqedoni në janar të këtij vitit arrin 24.025 denarë dhe është për 5.6 për qind më e lartë nga janari i vitit të kaluar, njoftoi Enti Shtetëror për Statistikë. Rritja është falë, para se gjithash, rritjes së neto pagës mesatare të paguar mujore për të punësuar në sektorët: Art, argëtim dhe rekreacion (37.3 për qind), Miniera dhe nxjerrjen e gurit (920.3 për qind) dhe bujqësi, pylltari, dhe peshkari (12.5 për qind). Rritje e neto pagës mesatare të paguar mujore për të punësuar, në krahasim me muajin paraprak, është shënuar në sektorët: Art, argëtim dhe rekreacion (31.4 për qind), Miniera dhe nxjerrjen e gurit (10.1 për qind) dhe Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicioner (6.3 për qind). Bruto paga mesatare e paguar mujore në janar të vitit 2018 arrin 35.225 denarë.

PARATË EUROPIANE TË PASHFRYTËZUARA



IPARDI NË QORRSOKAK!

Administrata duhet të del më shpesh nga zyrat e saja në orët e mbrëmjes nëpër fshatra, në kohën kur bujqit kanë më shumë kohë me qëllim që të sqarojnë kushtet e nevojshme për të aplikuar për fondet bujqësore evropiane

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 mars - Planet e papërgatitura të detajuara urbanistike të komunave, çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike, procedurat e papërfunduara të trashëgimisë, qasja e pamjaftueshme ndaj kapitalit fillestar, dokumentacioni voluminoz për aplikim, periudha e gjatë dhe e paqartë prej dorëzimit të projekteve deri tek miratimi i tyre, janë pengesat kryesore që pamundësojnë fermerët në Maqedoni të shfrytëzojnë më shumë të hollat e fondeve evropiane bujqësore IPARD. Në këto përfundime ka ardhur hulumtimi i Federatës së

Fermerëve të Maqedonisë me titull "Si deri tek shfrytëzimi më i suksesshëm i IPARD 2".

Nga ky hulumtim del se bujqit insistojnë që kërkesat për legalizim duhet të kenë prioritet, kur bëhet fjalë për shfrytëzimin e fondeve evropiane.

"Një pjesë e komunave akoma nuk i kanë të gatshme planet e detajuara urbanistike, si dhe janë të kufizuara me resurset për lëshimin e dokumenteve. Ne sugjerojmë që komunat deri në fund të vitit 2018, të përgatisin plane të tilla për shkak se ato janë kusht për lëshimin e lejeve për ndërtim", thotë Biljana Petrovska nga Federata e Fermerëve.

Analiza më tej i sugjeron administratës që më shpesh të dalë nga zyrat e saja në orët e mbrëmjes nëpër fshatra, në kohën kur bujqit kanë më shumë kohë me qëllim që të sqarojnë kushtet e nevojshme për të aplikuar për fondet bujqësore evropiane. Gjithashtu kërkohet rritja e kofinancimit për gratë fermere me qëllim që të rritet shfrytëzimi i mjeteve, kurse sugjerohet edhe thjeshtësimi i procedurave për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm. Një pjesë e tyre nevojitet që sipas detyrës zyrtare ti sigurojë Agjencia Pagesore apo Agjencia për përkrahje financiare në Bujqësi.

Edhe kompetentët nga Agjencia Pagesore thonë se nuk mund të jemi të kënaqur me shfrytëzimin e mjeteve të IPARD 1 ku nga mbi 3000 kërkesa në 12 thirrje janë paguar vetëm 1000 kontrata apo afër 16 milion euro. "Dobësitë e konstatuara duhet të ndihmojnë që mos përsëriten gabimet në programin e dytë apo IPARD 2 ku tani mund të shfrytëzohen 80 milion euro për të cilat ekziston interesim i madh", thotë drejtori i Agjencisë Pagesore, Nikollçe Babovski.

Maqedonia nga IPARD 2, deri në vitin 2023 mund të shfrytëzojë 80 milion euro prej të cilave 60 milion euro janë me kofinancim evropian dhe 20 milion euro janë përkrahje qeveritare me të cilat bujqësia vendore në vitet e ardhshme duhet të përmirësojë cilësinë e prodhimit si dhe ti afrohet standardeve të Bashkimit Evropian. Me fjalë të tjera, mjetet e IPARD-it synojnë ndër të tjerash rritjen e cilësisë së prodhimit bujqësor dhe konkurrencës së saj në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, përmirësimin e cilësisë së jetës në mjediset rurale, hapjen e vendeve të reja të punës dhe projekte të tjera.

Në vitet e kaluara si probleme në shfrytëzimin më të madh të të hollave evropiane për bujqësi ishin edhe frika e fermerëve nga marrja

e kredive, mungesa e ideve të reja për investime në bujqësi dhe blegtori dhe nënvlerësimi i vlerës së hipotekës në viset rurale për fitimin e kredisë.

Mjetet mund të shfrytëzohen për pesë masa kryesore, si modernizimi i ekonomive bujqësore, modernizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve prodhuese, infrastrukturë rurale, diversifikim ekonomik të mjedisve rurale apo hapje të bizneseve në fshatra dhe ndihmë teknike. Në vitet e kaluara nga Ministria e Bujqësisë, kishin përgatitur edhe projekte falas për ndërtimin e fermave dhe të mbjellave të ndryshme. Pra, fermerët nëse nuk kanë ndonjë ide të re që vetë të përgatisin projektet, mund të shfrytëzojnë projekte të gatshme në komunat e tyre. Ato mund t'i fitojnë falas në njësitë rajonale të Ministrisë së Bujqësisë. Bëhet fjalë për 27 projekte tipike për ndërtimin e fermave të kafshëve, ndërtimin e kapaciteteve për kultivimin e hardhive dhe pemëve, si dhe ndërtimin e staneve dhe siloseve. Krahas projekteve falas, bujqit në disponim kanë edhe Fondin Garantues. Me të hollat e fondit mbulohen gjysmat e hipotekës për kredinë që do ta marrin prej bankës. Njëherazi shteti mbulon edhe 50 për qind të kamatës për kreditë që merren për realizimin e projekteve IPARD.

Çmimi i banesave në Shkup ka rënë për 14 për qind

Shkup, 23 mars - Çmimi mesatar për metër katror i sipërfaqeve banesore në vitin 2017 ka qenë 41.822 denarë, që është për 2.9 për qind më pak në krahasim me vitin 2016, publikoi Enti Shtetë-

ror Statistikor.

Në Shkup çmimi mesatar për metër katror vitin e kaluar ka qenë 43.710 denarë, që është për 14 për qind më pak në krahasim me vitin 2016, ndërsa në vendet e

tjera të populluara në Maqedoni 32.001 denarë, që është për 2.2 për qind më pak në krahasim me vitin 2016. Në gjysmën e dytë të vitit të kaluar çmimi mesatar për metër katror është zvogëluar për

6.2 për qind në krahasim me gjysmën e parë të vitit, ndërsa në Shkup zvogëlimi arrin 4.8 për qind. Çmimet mesatare të cituara janë pa Tatimin e Vlerës së Shtuar.

CJETJE TË REJA PËR MINËN NË SOPOT (II)

E vërteta mbi fajtorët e vërtetë të rastit të Sopotit është fshehur në një raport të Shërbimit sekret të ARM-së. Aty janë përshkruar të gjitha detajet e kësaj ngjarje, mirëpo ka qenë insistimi me çdo kusht i DSK-së që hetimeve t'u jepet drejtim tjetër, ndërsa fajtorët e vërtetë të shpëtojnë duke ikur nga Maqedonia.



DSK-ja "HESHTI" USHTRINË, DEVIJOI PISTËN E HETIMEVE

Koha Vedat MEMEDALIU

Shkup, 23 mars - Një nga organet e sigurisë së Maqedonisë (Shërbimi Sekret i ARM-së, i cili në mënyrë kronologjike ka përshkruar tërë ngjarjen) i ka evidentuar të gjitha rrethanat e shpërthimit të minës në Sopot, më 4 mars të vitit 2003, me ç'rast jetën e humbën dy ushtarë polak të KFOR-it dhe një përkthyes nga Maqedonia.

RAPORTI USHTARAK

Ekziston një raport i Shërbimit sekret të ARM-së, i përpiluar menjëherë pas shpërthimit të minës në Sopot, i cili po të ishte marrë parasysh menjëherë, kjo ngjarje do të kishte epilog krejt tjetër. Sot, fajtorët e vërtetë për këtë akt terrorist do të ishin në burg, ndërsa banorët e Sopotit nuk do ta përjetonin ferrin që gjatë këtyre 15 viteve e paguan me disa vite burg dhe një viktimë. Sipas burimeve konfidenciale të gazetës KOHA, ky raport është fshehur qëllimisht nga presioni i Drejtorisë për Zbulim dhe Kundërzbulim (DSK-së), me të vetmin qëllim - të shpëtojnë kryerësit e veprës dhe ta pësojnë banorët e pafajshëm të fshatit Sopot. Mbi ekzistimin e këtij raporti sekret kanë pasur njohuri disa funksionarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes në të kaluarën, por edhe zyrtarë tjerë të shtetit.

KRONOLOGJIA E NGJARJES

Në afërsi të vendit të ngjarjes ku shpërtheu mina, ARM ka pasur atë kohë një karakoll ushtarak, prej nga janë vëzhguar edhe lëvizjet e njerëzve dhe aktivitetet e ndryshme në atë rajon. Gazeta KOHA mëson se ushtarët e ARM-së kanë raportuar që në fillim të kenë

„Në drejtim të karakollit kanë shkuar dy persona, për të raportuar se kanë parë një automjet të KFOR-it duke u djegur. Pikërisht këta persona, sipas informatave të gazetës KOHA, janë vetë kryerësit e veprës, për të cilët kemi shkruar dje, të cilët kanë ikur dhe që disa vite me radhë jetojnë të sigurt jashtë vendit

dëgjuar një të shtënë me armë zjarri, që sipas të dhënave tona, duhet të ketë qenë momenti kur dy personat që vendosën minën, janë zënë me njëri-tjetrin, zënkë kjo që ka eskaluar me plagosjen në këmbë të njërit prej tyre. Ushtarët kanë raportuar se pak më vonë në ditën kritike, kanë dëgjuar edhe një shpërthim, që duhet të ketë qenë momenti kur ushtarët polak me automjetin e tyre kanë shkëlur mbi minën e montuar në rrugë. Pas kësaj, në drejtim të ka-



rakollit kanë shkuar dy persona, për të raportuar se kanë parë një automjet të KFOR-it duke u djegur. Pikërisht këta persona, sipas informatave të gazetës KOHA, janë vetë kryerësit e veprës, për të cilët kemi shkruar dje, të cilët kanë ikur dhe që disa vite me radhë jetojnë të sigurt jashtë vendit.

MIJALLKOV: EDHE BUÇKO KA THËNË SE PO NDJEKIM NJERËZ TË PAFAJSHËM

Moment i ri në këtë hetim të gazetës KOHA është se në këtë ngjarje mund të jetë përfshirë edhe një person i tretë, i cili ka shërbyer si logjistikë. Këtë e dinë edhe institucionet relevante në këtë shtet. Megjithatë, ky raport nuk ka arritur të shohë dritë asnjëherë, bile as në Komisionin parlamentar që u formua për t'u rishqyrtuar procedura hetimore dhe gjyqësore nga fillimi deri në fund. Ky dokument ishte fshehur nga deputetët, anëtarë të këtij Komisioni. Duket se këtë dokument e ka parë edhe ish-ministri i Mbrojtjes, Vllado Buçkovski, i cili përmendet në një bisedë telefonike në "bombat" e Zaevit, në mes të Gordana Jankullovsks dhe Sasho Mijallkov, kur ky i fundit në një moment thotë: "Edhe Buçko ka

thënë se po ndjekim njerëz të pafajshëm".

DEVIJIMI I HETIMEVE

Në vend që hetuesit t'i marrin në konsideratë të dhënat e raportit të përpiluar atëherë nga Shërbimi Ushtarak i Maqedonisë, punonjësit e lartë të DSK-së i kanë dhënë kahe tjetër hetimeve. Dy personat e përmendur në raportin në fjalë, asnjëherë nuk janë marrë në pyetje nga policia e Maqedonisë. Për këtë shkak, njëri prej tyre menjëherë është larguar drejt Francës, ndërsa tjetri edhe një kohë të gjatë ka qëndruar në Maqedoni, për të ikur pastaj në Kosovë, ku burgoset dhe për disa vite mbahet në burgun Bonstill të KFOR-it. I njëjti më vonë ekstradohet në Maqedoni ku vuan dënimin për disa vepra tjera terroriste. Pas lirimit nga burgu, ai shpërngulet në një shtet fqinj ku gjendet edhe sot. Ajo që vlen të theksohet është se implikimin e këtij personi në rastin e Sopotit e ka vërtetuar edhe bashkëshortja e saj, e cila në vitin 2009, këtë e ka dëshmuar para organeve kompetente në Maqedoni. Asnjë nga këto fakte nuk janë marrë parasysh nga tetë punonjësit e DSK-së, që sipas informatave tona, kanë qenë të përfshirë në hetimet e këtij rasti.

Ata kanë zgjedhur që hetimet të marrin kahe tjetër dhe kështu ka ndodhur, duke keqtrajtuar Ramadan Bajramin, të cilin e kanë arrestuar dhe ia kanë bastisur shtëpinë disa herë, para dhe pas shpërthimit të minës, madje edhe në kohën kur ky ka qenë në paraburgim, me të vetmin qëllim që ti bëjnë presion plotësues për të mos e ndryshuar deklaratën e dhënë si pasojë e dhunës së ushtruar ndaj tij.



Heronjtë e padukshëm që zbuluan skandalin e përgjimeve do të fitojnë çmimin për lirinë e shprehjes

Shkup, 23 mars - Gjorgji Llazarevski dhe Zvonko Kostovski, të punësuarit në DSK, të cilët kanë zbuluar skandalin me përgjimet në Maqedoni, do të fitojnë çmimin vjetor "Çmimi për liri të shprehjes", i cili u është ndarë në Prishtinë më 23 mars, shkruan gazeta KOHA. Si kolegë në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim, Llazarevski dhe Kostovski tre vjet kanë punuar me qëllim që të dokumentojnë përgjimet e paligjshme ndaj mbi 20.000 biznesmenëve, aktivistëve, gazetarëve dhe të tjerëve me mendime ndryshe nga qeveria e kaluar. Publikimi i një pjese të bisedave të përgjuara në vitin 2015 rezultoi me zgjedhje të reja në vitin 2016 dhe formimin e qeverisë së re në vitin 2017. Krahas asaj, bisedat kanë qenë dëshmi për akuzë ndaj 94 personave dhe shtatë kompanive. Për shkak se vuri në dukje përgjimet e paligjshme, Gjorgji Llazarevski mbajti 11 muaj burg. Sot ai është i lirë dhe edhe pse rrallë paraqitet në publik, më 23 mars do të bëjë përjashtim për të pranuar "Çmimin për liri të shprehjes" në emër të tij dhe në emër të kolegut të tij Kostovski. "Çmimi për lirinë e shprehjes" është mirënjohje vjetore e cila ndahet nga ana e Koalicionit për mbrojtje të fishkëllyesve në Evropën Juglindore dhe Qendrës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të fishkëllyesve. Të dyja organizatat bashkëpunojnë me aktivistë lokale dhe gazetarë në Kosovë që të organizojnë Ditën ndërkombëtare të fishkëllyesve dhe Javën për lirinë e shprehjes në Kosovë prej më 19 deri në 24 mars.

KRONIKË

Gjendet në Shkup
vetura e vjedhur
në Tetovë

Të enjten mbrëma rreth orës 23 e 30 minuta, në rrugën Lokov, në Shkup, para një ndërtese është gjetur vetura e tipit Land Rover, me targa të Tetovës e cila ishte vjedhur një ditë më herët para një barnatore në Tetovë. Vetura me vërtetimi është kthyer pronarit 40 vjeçar A.O nga Tetova, i cili e kishte denoncuar të vjedhur. Policia punon në zbardhjen e plotë se kush e ka vjedhur këtë veturë.

Aksident trafiku
në Zhelinë

Të enjten mbrëma rreth orës 20 e 15 minuta veturë e tipit Mercedes me targa të Tetovës ka humbur kontrollin dhe ka goditur një shtyllë betoni. Aksidenti ka ndodhur në afërsi të pikës së pagesës në Zhelinë, ndërsa është drejtuar nga 48 vjeçar M.B nga Tetova. Sipas policisë, shkak për këtë aksident ka qenë shpejtësia e papërshtatshme me kushtet në rrugë. Mbrëmë janë regjistruar dhe disa aksidente në rrugët e Tetovës dhe rrethinës, por të gjitha kanë përfunduar me dëme materiale.

Plaçkitet laboratorit
Fakultetit Farmaceutik

Janë plaçkitur pajisje dhe gjësende në vlerë prej 300.000 denarësh në një plaçkitje të rëndë në laboratorin e Fakultetit Farmaceutik në kuadër të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodij" në Shkup. Nga fakulteti dje kanë denoncuar në polici se në periudhën prej orës 19 më datën 20 të këtij muaji deri në orën shtatë në mëngjes një autor i panjohur ka kryer plaçkitje të rëndë. Plaçkitësi me gjësend të fortë e ka thyer xhamin, ka hyrë brenda dhe i ka marrë dy peshore digjitale laboratorike, dy LCD monitorë dhe një kompjuter, me ç'rast është larguar në drejtim të panjohur. Në këtë mënyrë ka përfutur dobi pronësore të paligjshme prej rreth 300.000 denarë, thekson MPB në Buletinin e rregullt ditor. Janë duke u ndërmarë masa për gjetjen e autorit dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Kamioni del nga
rruga, vdes shoferi

Një banor gjashtëdhjetë e pesë vjeçar nga fshati Tarincë ka humbur jetën pasi me automjetin e transportit ka dalë nga rruga Plaçkovicë - Shtip dhe ka goditur një pemë. Siç është theksuar në buletin e policisë, të enjten rreth orës 14:10 në rrugën rajonale Plaçkovicë - Shtip para udhëkryqit për në fshatin Kozjak, D.V.(65) nga fshati Tarinici - Komuna Karbinci, duke drejtuar automjetin motorik të transportit "Zastavë 621" me targa nga Shtipi ka humbur kontrollin mbi automjetin, me pas ka dalë nga rruga dhe ka goditur një pemë. Ekipe të ndihmës mjekësore urgjente kanë konstatuar se D.V. ka ndërruar jetë në vendngjarje. Hetim është bërë nga ekipet e SPB Shtip dhe prokurori publik. (O.Xh)

AVOKATI I POPULLIT ME AKUZA TË REJA NDAJ KRYEPROKURORIT

RASTI I ALMIRIT,
ÇELËSI TE JOVEVSKI

"Nëse je prokuror i fort, atëherë ndryshoje gjithë procedurën. Hap hetime për personat që e kanë kryer ekspertizën dhe të shohim çfarë do të dalë. I gjithë problemi qëndron se si i konceptojmë të gjitha këto punë. Jemi të zhgënjyer nga ky vendim. Kjo e shkatërron sistemin. Mos mendoni se ne kemi kryeprokuror të ri dhe kështu kthehet besimi i opinionit...", thotë Memeti

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 23 mars - Cila mendje e shëndosh mund të pranojë një vendim të tillë, siç është në rast i Almiri. Më vjen turp si Ombudsmen, të jetoj në një shoqëri ku prokurori, një vrasje, qoftë ajo edhe nga pakujdesia, ajo është vrasje, ta rikualifikojë në aksident komunikacion. Kështu ka thënë për gazetën KOHA, Avokati i Popullit, Ixhet Memeti, i cili ka përsëritur konstatimet e të deleguarve të Zyrës së tij se, gjatë procedimit të rastit Almir Aliu, janë shkelur disa procedura të rëndësishme gjyqësore.

"Shumë është e qartë. Janë kacafytur dhe ky e ka marrë veturën ta godas apo ta frikësojë prindin, dhe kështu ka mbytur fëmijën katërvjeçar. Tepër me rëndësi është veprimi i kryeprokurorit, i cili thotë se në shkresa shënon kështu e ashtu. Nëse je prokuror i fort, atëherë ndryshoje gjithë procedurën. Hap hetime për personat që e kanë kryer ekspertizën dhe të shohim çfarë do të dalë. I gjithë problemi qëndron se si i konceptojmë të gjitha këto punë. Jemi të zhgënjyer nga ky vendim. Kjo e shkatërron sistemin. Mos

mendoni se ne kemi kryeprokuror të ri dhe kështu kthehet besimi i opinionit. Besueshmëria rritet, kthehet me vendime të cilat opinionin i pranon", thotë Memeti, ndërsa siguron se këtë rast do ta përcjellin deri në fund. Memeti shpreh indinjatë edhe për heqjen e aktakuzës për dhunë të vëllait të vrasësit Boban Iliq, Bojanit, i cili qartë shihet në filmime se me mjet të fortë, merr pjesë në zënkën me familjarët e Almiri.

"Shumë qartë do ta themi. Fillimisht kanë ekzistuar katër aktakuza, për veprën 'dhunë'. Tre prej tyre për të afërmit e fëmijës së ndjerë, dhe njëra për vëllain e të akuzuarit. Tash për vëllain e kanë tërhequr aktakuzë, se ai nuk ka qenë dhunues. Ndërkohë, prokurorja djersitet dhe mundohet të tregojë se ky nuk ka pasur qëllim, por se ka qenë aksident. Ajo harron se gjatë marrjes së vendimit për dalje nga paraburgimi, pikërisht i akuzuari gjatë daljes nga burgu silltet në atë mënyrë të cilën të gjithë e pamë. Kjo nuk është dëshmi e mjaftueshme se vepra është 'vrasje'?"

A nuk është dëshmi kjo se askush nuk mund t'i bëjë më asgjë?", thotë Memeti.

Më së paku, thotë Memeti, personi i cili është akuzuar për "vrasje" dhe tash për "aksident komunikacioni", është dashur që pas daljes nga paraburgimi, të shkojë të kërkojë falje te familja e viktimës, të kërkojë falje nga gazetarët, se me të vërtetë rasti ka qenë aksident. "Dhe, jo gjatë largimit nga burgu të silltet me atë lloj arrogancë. Prokurori duhet t'i merr parasysh këto gjëra. Të hapë procedurë të re. Fillimisht për prokuroren, e cila në mënyrë joprofesionale e procedon rastin. Si mundet të mos ekzistojë vetura, e cila është lëndë e vrasjes dhe tani të humbet? Dhe plotë dokumente tjera. Shoqërisë tonë nuk i ndihmojnë këto veprime. Sistemet nuk reformohen me njerëzit e njëjtë dhe struktura e cila gabimisht vepron", thotë Memeti, duke potencuar se pikërisht Jovevski dhe punë e prokurorit është të grumbullojë hetime dhe prova për rastin, e jo siç ndodhi në këtë rast, të mos merren parasysh dëshmitë e palës mbrojtëse. "Nuk guxon që Prokurorisë t'i vonohen ekspertizat, për të cilat dëgjuam, ndërsa asnjëra nga dëshmitë e ofruara të palës mbrojtëse të mos merret parasysh".

JOVEVSKI NUK HEQ DORË NGA RIKUALIFIKIMI

Kryeprokurori Ljubomir Jovevski, ndërkohë ka përsëritur se qëndron pas rikualifikimit të lëndës nga "vrasje" në "aksident trafiku me pasojë vdekje". Madje, në një intervistë për javoren "Fokus", Jovevski ka përsëritur arsyet se pse ka ardhur deri tek rikualifikimi i lëndës. "Vetë prokurorja, duke i shqyrtuar të gjitha dëshmitë, ka vlerësuar se nuk mund të qëndrojë aktakuza me vepër penale, e cila e ngarkon Iliqin, dhe ka vendosur ta rikualifikojë atë. Të dëmtuarit supozuan se do të bëhet rikualifikim, dhe kundër prokurores kishin ngritur ankimum në Prokurorinë e lartë publike. Atëherë Prokurorja është thirrur ta referoj lëndën, pas çka është sjell vendim të bëhet rikualifikim në "lëndë të rënda kundër sigurisë së personave dhe pronave në komunikacion", sqaron Jovevski, dhe sipas tij, nga dhjetëra prokurorë, vetëm dy kanë qenë kundër ndryshimit. Ai shton se lënda është referuar edhe para Prokurorisë republikane publike ku edhe është vërtetuar vendimi. "Edhe këtu silltet vendimi i njëjtë, ndërsa katër prokurorë janë shprehur kundër", thotë Jovevski, i cili shton se në të dy rastet nga gjithsej 25 prokurorë, gjashtë nuk janë pajtuar për rikualifikim.



MUNGESA KADROVIKE NË MUZEUN E MANASTIRIT

MUZEU I ALFABETIT, PA HISTORIAN E GJUHËTAR

Pa historian dhe gjuhëtar, ky muze renditet ndër institucionet e rralla nacionale në vend që nuk i posedon kushtet minimale për zhvillimin normal të punës. Drejtori aktual, si ish historiani i vetëm i punësuar në këtë muze, vazhdon të luajë këtë rol në mungesë të një zëvendësuesi. I pazëvendësuar ka mbetur edhe vendi i gjuhëtares së vetme në këtë muze, që u nda nga jeta disa muaj më parë



Koha

Evis HALILI

Shkup, 23 mars - Me gjithsej gjashtë të punësuar, Muzeu i Alfabetit në Manastir funksionon me mangësi të theksuara kadrovike. Pa historian dhe gjuhëtar, ky muze renditet ndër institucionet e rralla nacionale në vend që nuk i posedon kushtet minimale për zhvillimin normal të punës. Drejtori aktual, si ish historiani i vetëm i punësuar në këtë muze, vazhdon të luajë këtë rol në mungesë të një zëvendësuesi. I pazëvendësuar ka mbetur edhe vendi i gjuhëtares së vetme në këtë muze, që u nda nga jeta disa muaj më parë. Sipas drejtorit Nuer Arslani, investimi më i mirë për muzeun janë punësimet dhe kompletim i tij me staf të specializuar, nëse presim që muzeu të jetë në nivelin e të gjitha institucioneve të tjera nacionale. Një situatë dhe probleme të ngjashme janë trashëguar prej gati dhjetë vitesh, madje as kur statusi u ndryshua nga shtëpi në muze. Nga ky institucion thonë se kanë bërë kërkesë për disa punësime të reja, historian, albanolog dhe personel tjetër, edhe pse drejtori Nuer Arslani

pohon se këto profile janë të vështira për t'u gjendur.

"Përveç pengesave që zakonisht bëhen nga Ministria e Financës, problem është edhe mungesa e këtyre profileve. Kemi kërkuar në Manastir dhe rrethina, por është vështirë të gjendet, qoftë një historian, apo albanolog. Shpresë mbeten qytetet pak më larg, si Strugë, Kërçovë dhe ndonjë vullnetar që do të pranonte të punësohej në muze. Unë jam historiani i vetëm, kustosi është pedagog me profesion, ndërsa albanolog s'ka dhe presim në miratimin e kërkesave që i kemi drejtuar", thotë Arslani. Në Muzeun e Alfabetit që prej vitit të kaluar është krijuar një kënd për fëmijë, edukativ dhe argëtues ku nxënës të moshave dhe klasave të ndryshme mësojnë duke luajtur me shkronja në orë që zgjasin 40 minuta. Aktivitete të ngjashme, por me nxënës të shkollat e mesme edhe nga qytete të tjera si Struga janë pjesë e programit të këtij institucioni. Me restaurimin e objektit këndi do të zhven-

doset në katin e parë, ku do të krijohet edhe një hapësirë për shfaqje filmash dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme edukative.

"Nevoja për punonjës të profilizuar është e madhe. Investimi më i mirë për këtë institucion janë punësimet, kompletim i tij me staf të specializuar, që do të mund të siguronte të paktën ecurinë normale të punës, por edhe të zhvillonte perspektiva të reja për këtë institucion. Kjo çështje duhet të zgjidhet

sa më shpejt nëse presim që muzeu të jetë në nivelin e të gjitha institucioneve të tjera nacionale", thotë Arslani.

Këtë vit muzeu bëhet gati për shënimin e përvjetorit të 110-të të Kongresit të Manastirit, datë kjo që me manifestime të ndryshme artistike-kulturore do të shënohet edhe në qytete të tjera, si Shkup, Tiranë e Prishtinën, si një prej datave të kalendarit festiv mbarëshqiptar - Vitit të Gjergj Kastriotit.

RIKONSTRUKTIMI NIS NË FUND TË PRILLIT

Rikonstruktimi i muzeut, i financuar nga fondet e zhvillimit IPA supozohet se do të fillojë në fund të muajit të ardhshëm. Janë rreth 300 mijë euro për realizimin e këtij projekti që do të rikthejnë në identitet ish shtëpinë ku u mbajt Kongresi i Alfabetit. Ky është investimi i parë serioz për sigurimin e kushteve normale të funksionimit, krijimin e ankesave dhe hapësirave të nevojshme si për ekspozitat, ashtu edhe për sistemimin e dhomës përkujtimore me 11 figurat në silikon të nënshkruesve të Alfabetit. "Gjithçka është gati, duhet që së bashku me bartësin e projektit komuna Volvit në Greqi dhe partnerët e tjerë që kemi marrë mbështetjen e IPA të takoni në fillim të muajit prill për të nënshkruar edhe ne memorandumin e bashkëpunimit. Dhe sipas afateve që i kemi përcaktuar punimet do të përfundojmë brenda pak muajsh", thotë drejtori.

Konfiskohen celularët e deputetëve në burgun e Shutkës

Shkup, 23 mars - Deputetëve dhe funksionarëve të lartë të MPB-së, të dyshuar për inskenim të ngjarjeve të 27 prillit, u janë konfiskuar telefonat celularë, të cilat i kanë shfrytëzuar brenda burgut hetues të Shutkës në Shkup. Organe e rendit, siç raportojnë mediat, ende nuk e kanë të qartë se në çfarë mënyrë janë futur telefonat celular në burgun e Shutkës, gjegjësisht dyshimet janë se përmes pakove të ushqimeve, në një farë mënyrë janë kontrabanduar celularët. Të dhënat jozyrtare nga burgu i Shutkës flasin se bëhet fjalë për konfiskimin e pesë apo gjashtë telefonave celularë, të cilat janë zbuluar në qelitë e deputetëve Kërste Mukovski e Sasho Vasilevski, ish eprorit të MPB-së, Oliver Popovski dhe truprojs së ish-kryeparlamentarit Trajko Veljanovskit.

Informacionet flasin se një pjesë e të paraburgosurve, përmes këtyre telefonave, kanë zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me njerëzit e partisë dhe diskutimeve kanë qenë rrethana për të cilat ato gjenden në paraburgim, si dhe sigurimin e provave shtesë për procedurën hetimore për ngjarje e 27 prillit. Në interes të hetimeve, për momentin nuk zbulohen detaje tjera. Gjykata e Lartë e Maqedonisë ditë më parë zhvilloi seancë publike lidhur me ankesat e parashtruar për vendimet e Gjykatës së Apelit, për vazhdimin e paraburgimit të një pjesë të akuzuarve për ngjarjet e prillit të vitit të kaluar. Pala mbrojtëse e të akuzuarve ka theksuar se vendimet e Gjykatës së Apelit janë paushalë dhe jo mjaft të arsyetuara.

(O.XH)

Prolongohet përballja Mijallkov-Boshkovski

Shkup, 23 mars - Ndonëse pritej, ish funksionarët e lartë të Ministrisë për Punë të Brendshme, Sasho Mijallkov dhe Lube Boshkovski, në cilësinë e palës së akuzuar dhe të dëmtuar, të premtën nuk u ballafaquan para Gjykatës Penale të Shkupit. Shërbimet e GJPSH-së, pas pranimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, se edhe ish-njeri i parë i policisë sekrete, Sasho Mijallkov, mund të gjykohej në rastin "Tortura", nuk kanë arritur ta gjejnë adresën e banimit për dorëzimin e ftesës për seancë gjyqësore. Përfaqësuesi i Prokurorisë Speciale Publike, Lubomir Llape,

me këtë rast i propozoi Trupit gjykoes në krye me gjykatësen Aleksandra Ristevska, që ftesa për seancë e të akuzuarit Mijallkov t'i dorëzohet në njërin prej seancave të ardhshëm që zhvillohen kundër tij. "Siç dihet, ndaj të akuzuarit Sasho Mijallkov, përveç kësaj lëndë, zhvillohen edhe disa procese tjera gjyqësore. Kështu që vlerësoj se në seancën e radhës të rastit 'Target-Fortesa', të martën me 27 prill, ku i akuzuari Mijallkov ngarkohet si i dyshuar, mendoj se duhet ta shfrytëzoni kohën dhe ta njoftoni për kohën se kur do të zhvillohet seanca e radhës për lëndë

"Tortura", tha, prokurori speciale Llape. Meqë edhe në këtë seancë nuk kishte kushte për vazhdim të shqyrtimit kryesor dhe parashtrimin të fjalëve hyrë, seanca për rastin "Tortura", u prolongua për datë 7 maj. Për tejkalim të kompetencave dhe dhunën e ushtruar ndaj Boshkovskit, në korrik të vitit 2011, gjendet edhe një pjesë e njësitit "Alfa". Listën e pjesëtarëve të kësaj njësie për intervenim të shpejtë të MPB-së e përbëjnë Ivica Ançevski-Puki, Novica Stankovski, Petar Milloshevski, Jovan Bocevski, Filip Atanasov dhe Metush Shabani. (O.XH)





info@scboristrakovski.gov.mk | www.scboristrakovski.gov.mk

Në pajtim me Ligjin për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16) dhe nenit 29 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënie me qira të hapësirës afariste e cila është në pronë dhe me të cilën menaxhon Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup (nr. Ark. 02-2148/2 të datës 11.11.2015)

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup

me seli në bul. 8-mi Septemvri nr. 13 Shkup

PUBLIKON

SHPALLJE nr. 02/2018

PËR DHËNIE ME QIRA TË HAPËSIRËS AFARISTE PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

LËNDË E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lëndë e ankandit publik elektronik është **DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS AFARISTE**, në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në pajtim me Pasqyrën tabelore në të cilin janë dhënë të dhëna për hapësirën afariste, nr. i parcelës kadastrale, sipërfaqe të hapësirës afariste, adresa, çmimi i përgjithshëm fillestar, garancia bankare, afati i parashtrimit dhe koha e ankandit publik.

Hapësira afariste e cila është lëndë e ankandit publik elektronik është në pronësi të Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, jepet për periudhë prej 3 (tre) vjet, me mundësi për vazhdim të marrëveshjes.

1. Hapësira afariste i cili gjendet në Vip Arenën në kompleksin e Qendrës Sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të parë).

Nr. r.	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1.	PK 566/4 KK Karposh LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"hapësira afariste në përdhese – përdim"	31	10.295,00	2.059.044,00	41.181,00	10.04.2018	13.04.2018 09:00
2.	PK 566/4 KO Kapnou LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	hapësira afariste në përdhese – lindje"	32	10.485,00	2.096.904,00	41.938,00	10.04.2018	13.04.2018 11:00
3.	PK 566/4 KK Karposh LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"kafe-renorant" në përdhese	182	60.400,00	12.079.947,00	241.599,00	10.04.2018	13.04.2018 13:00
4.	PK 566/4 KK Karposh LP 47329	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri nr. 13	"hapësirë afariste nr. 11" në bodrum	81	18.681,00	3.736.125,00	74.723,00	10.04.2018	13.04.2018 15:00

2. Hapësira afariste i cili gjendet në Vip pishinën në kompleksin e Qendrës Sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup (për herë të parë).

Nr. r.	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe lista pronësore	Qyteti, Komuna, Adresa	Përshkrimi i hapësirës afariste	Sipërfaqja m2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera mesatare e tregut) pa TVSH	Vlera e përgjithshme vlerësuar e hapësirës afariste në denarë	Garancia bankare për seriozitet të ofertës në denarë, 2% nga vlera e përgjithshme vlerësuar	Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik	Koha e fillimit të ankandit publik
5.	PK 550/3 KK Karposh LP 4917	Shkup, Karposh, bul. 8-mi Septemvri	"restaurant" Në katin e parë	58	14.854,00	2.970.760,00	59.415,00	10.04.2018	13.04.2018 17:00

VËREJTJE: Ofertuesi më i volitshëm për hapësirën afariste të shënuar si "restaurant" në katin e parë me sipërfaqe prej 58 m2, PK 550/3, KK Karposh dhe LP 4917 i cila gjendet në Vip pishinën në kompleksin e Qendrës Sportive BORIS TRAJKOVSKI, do të mund të shfrytëzohet edhe parter hapësirë me sipërfaqe prej 20 m2 PK 550/3, KK Karposh dhe LP 81039 e cila gjendet në katin përdhese para Vip pishinës për vendosje të pajisjes urbane, për kompensim mujor prej 1.500,00 denarë – çmimi i përcaktuar sipas Vlerësimit të shumës së pronës së patundshme Raporti NR. NI 0417-004 të datës 07.04.2017 të përpiluar nga Shoqëria për edukim, trajnim dhe hulumtim AM CERT SHPKNJ Shkup.

Kompensimi i para theksuar mujor do të paguhet duke u llogaritur nga dita e përcaktuar në procesverbal si dita e parë e shfrytëzimit të parter hapësirës gjatë sezonit veror për secilin vit veç e veç ndërsa deri në muajin kur i njëjti do të ndërpritet të shfrytëzohet gjatë viti gjegjësisht prej fillimit të sezonit dimëror.

Qiraja në marrëveshje për qiranë është dhënë në shumë neto – pa TVSH. Tatimi i vlerës së shtuar shënohet në vend të posaçëm në faturë.

Qiramarrësi obligohet që qiranë ta paguajë në afat prej një dite nga dita e marrjes së faturës.

Për mos pagesë në kohë të qirasë do të përlogaritet kamatë ndëshkuese ligjore.

Mospagesa e 2 (dy) qirave të njëpasnjëshme mujore, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me qira, paraqet bazë për aktivizimin e mjeteve për siguri dhe bazë për ndërprerje të marrëveshjes nga ana e Shoqërisë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.

TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë:

1. **Subjektet fizike:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe shtetas të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Subjekte juridike:** person juridik lokal, person juridik në pronësi të përzier, person juridik të themeluar nga personi fizik dhe juridik i huaj, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona juridik të huaj rezidentë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe persona juridik të huaj rezidentë të shteteve të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD ndërsa të cilët me kusht të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë të tokës ndërtimore në territor të Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Subjektet e interesuara fizike dhe juridike për secilin hapësirë afariste veç e veç, paraqiten në sistemin për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk.

Dokumentet në formë me shkrim dorëzohen në Shoqërinë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në zarf të mbyllur me shenjë "Mos hap deri në përfundim të shpalljes".

Fletëparaqitja në internet portalin www.deloven-prostor.mk dhe në formën me shkrim duhet të kompletetohet në mënyrë identike me dëshmitë në vijim:

1. Subjektet e interesuara fizike dhe juridike paraqiten në sistemin për shitje dhe dhënie me qira të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht në internet portalin www.deloven-prostor.mk. Dokumentet në formë me shkrim dorëzohen në Shoqërinë për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, në zarf të mbyllur me shenjë "Mos hap deri në përfundim të shpalljes".

2. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik në shumë prej (2% të vlerës së caktuar) me afat të kohëzgjatjes prej 60 ditëve nga dita e ankandit publik vetëm në original (të shënohet numri rendor nga pasqyra afariste dhe adresa ku gjendet objekti afarist).

3. Për subjektet fizike certifikatë të shtetësisë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj.

4. Për subjektet juridike gjendje aktuale nga Regjistrin qendror i Republikës së Maqedonisë (për ofertues të huaj dëshmi përkatëse për regjistrim të subjektit juridik të dhënë nga regjistri përkatës), në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, jo më të vjetër se 6 muaj.

5. Pjesëmarrësit e interesuar regjistrohen në portalin www.deloven-prostor.mk me futjen e e-mail adresës së parashtruesit të fletëparaqitjes përmes së cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, sipas së cilës do të duhet të aktivizojë llogarinë përdoruese (Shih udhëzimet për shfrytëzuesit të www.deloven-prostor.mk).

6. Deklaratë se në rast se oferta e tij zgjidhet si më e volitshme obligohet të paguajë mjetet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje, ndërsa garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe ofertuesit do të shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

7. Gjatë dorëzimit të dokumenteve, ofertuesit të interesuar në fushën "Deklaratë" duhet të fusin në një dokument të gjitha dokumentet e nevojshme nga shpallja përveç Garancisë bankare, ndërsa në sferën "Garancia bankare" dorëzohet garancia e skanuar bankare.

Fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtruesit e fletëparaqitjeve të pakompletuara do të informohen në mënyrë elektronike.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen në shtëpinë në afat prej 20 ditë nga dita e shpalljes, gjegjësisht duke filluar prej 22.03.2018 deri më 10.04.2018 deri në ora 16:00, përmes mënyrës elektronike në internet faqen: www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të mbahet në formë elektronike në internet faqen në vijim www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të fillojë në terminin e dhënë në pasqyrën tabelore, për secilin hapësirë afariste veç e veç.

PROCEDURA

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton kompletimin e dokumenteve në pajtim me kushtet në shpallje, pas së cilës do të informon parashtruesit e fletëparaqitjeve në mënyrë elektronike.

2. Parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në mënyrë elektronike e miraton pjesëmarrjen në ankandin publik pas së cilës informohen përmes mënyrës elektronike me e-mail, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar, komisioni nuk do të miratojë pjesëmarrjen në ankandin publik për çka do të informojë përmes formës elektronike për shkaqet e refuzimit.

3. Ankandi do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e dhëna në shpallje.

4. Ankandi publik do të mbahet edhe në qoftë se thirrjes së shpalljes i përgjigjet vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e dhëna në shpallje.

5. Ankandi publik do të fillojë me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, gjegjësisht ta rrisin çmimin e hapësirës afariste.

Ankandi publik konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës, gjatë së cilës nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re.

6. Ankandi publik vazhdon pakufi derisa në intervalin kohorë prej dy minutave ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të të ankandit publik nuk pranohet oferta, gjegjësisht nuk jepet ofertë më e lartë, çmimi i përgjithshëm fillestar e hapësirës afariste ulet për 2% pas së cilës pjesëmarrësit në ankandin publik sërish do të kenë mundësinë të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste.

7. Nëse pas kalimit të dy minutave të fundit të pesë minutave të dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht jepet ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhë prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë e re.

8. Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish ulet për 2% nga vlera e përgjithshme e hapësirës afariste. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste gjatë ankandit mund të jetë më së shumti deri në 30% e çmimit të caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht shuma e përgjithshme e vlerësuar për qiranë mujore të objektit afarist nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të parë,

pavarësisht sa ofertues janë paraqitur në ankandin publik. Ulja e çmimit të përgjithshëm fillestar të hapësirës afariste nëse bëhet fjalë për shpallje për herë të dytë, mund të jetë së paku deri në 30% nëse në ankandin publik është paraqitur një pjesëmarrës i interesuar, ndërsa nëse janë paraqitur dy ose më shumë pjesëmarrës, ulja mund të jetë më së shumti 50% të vlerës së caktuar të tregut të hapësirës afariste, gjegjësisht të shumës së përgjithshme të vlerësuar për qiranë mujore të hapësirës afariste.

9. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet deri tek pjesëmarrësit në ankandin publik.

10. Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri tek Komisioni, i cili vendosë në lidhje me ankesën me Vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës.

11. Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit më të lartë të përgjithshëm, i cili paraqet çmimin më të lartë për qira të objektit afarist.

12. Ofertuesi më i volitshëm është i obliguar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje të paguajë mjetet dhe deri tek Komisioni të dorëzohet dëshmi, në të kundërtën nuk do të lidhet marrëveshje ndërsa garancia bankare do të aktivizohet ndërsa ofertuesit do të shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurat për ankand publik për tjetërsim ose dhënie me qira të hapësirave afariste në periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.

13. Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në afat prej 5 (pesë) ditëve pas pagesës së realizuar të një qirave mujore në shumë të arritur të çmimit në procedurë për ankand publik do të lidhë marrëveshje për qira të hapësirës afariste me ofertuesin më të volitshëm.

14. Tatimi i vlerës së shtuar bie në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

15. Marrëveshja për qira të hapësirës afariste solemnizohet në Noter në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

16. Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për qira.

17. Subjekti fizik, subjekti juridik dhe themeluesi i subjektit juridik, i cili në cilëndo bazë ka obligime të papaguara ndaj BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, nuk mund të merr cilësinë e qiramarrësit në BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup.

18. Qiramarrësi pas lidhjes së Marrëveshjes për qira në afat prej 7 (shtatë) ditëve duhet të sigurojë Garanci për sigurim të obligacioneve që do të dalin në bazë të marrëveshjes së nënshkruar:

- Shumë të 3 qirave mujore (gjegjësisht të njëjtat të paguhen në xhiro llogarinë e qiradhenësit) ose
- Garanci bankare në shumë prej 3 (tre) qirave mujore.

19. Të gjitha lejet e nevojshme për realizimin veprimtarisë i siguron qiramarrësi.

Kjo shpallje do të publikohet në dy gazeta ditore të cilat publikohen në gjuhën maqedonase, ndërsa dalin së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes: NOVA MAKEDONIJA dhe VEÇER dhe një gazetë ditore i cili botohet në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit në cilin rajon gjendet hapësira afariste lëndë e publikimit, ndërsa del së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes – KOHA.

Të interesuarit hapësirën afariste mund ta vizitojnë çdo ditë pune qira 10:00 deri në ora 14:00.

Informata më të detajuara mund të merren në selinë e BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup në bul. 8-mi Septemvri nr. 13, dhe përmes personave për kontakt:

Oliver Kitanovski 076/361176 e-mail: oliver.kitanovski@scboristrakovski.gov.mk (për çështje juridike)
Lupco Tomovski 076/361184 e-mail: ljupco.tomovski@gmail.com (për çështje të tjera)

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup
Kryetari i komisionit për realizim të procedurave për ankand publik

Roberta Teova



Ministria Deskovska i sheh institucionet private arsimore si nxitës të konkurrencës pozitive dhe pjesë të reformës për rritjen e cilësisë në arsim. Edhe pse sigurimi i arsimit fillor dhe të mesëm është barrë që bie mbi shtetin, në MASH janë dyert e hapura edhe për iniciativa private, të cilat nënkuptojnë përmirësimin e cilësinë arsimore në Maqedoni

SHKOLLAT PRIVATE KONKURRENCË POZITIVE E CILËSISË

NGA SHTATORI NIS MËSIMI NË AHSS



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 23 mars - Nga shtatori i këtij viti, Gjimnazi Amerikan në Shkup (American High School - Skopje), do të hap siparin me 25 nxënës të gjeneratës së parë, të cilët pas katër viteve do të marrin në fund të shkollimit të tyre një diplomë të barasvlershme me të gjitha diplomat që ndajnë institucionet e akredituara arsimor në Maqedoni. Mësimi në këtë gjimnaz privat do të zhvillohet në gjuhën angleze, në përjashtim të lëndës gjuhë dhe letërsi maqedonase, e cila do të jetë edhe gjuha në të cilën duhet të jepen provimet e maturës shtetërore në përfundim të shkollimit.

Qëllimi i këtij institucioni, sikurse tha Venera Kërliu Hanxhiski, është vazhdimi i përvajave pozitive të investimit në sektorin privat, respektivisht institucionet private arsimore në Maqedoni. "Dua të shpreh falënderimin tim dhe krenarinë për kolegjin Amerikan në Shkup që si lider i sistemit e vazhdon veprimtarinë e vet në sferën arsimore dhe vazhdon praktikën pozitive me hapjen e kësaj shkolle të mesme, American High School - Skopje", u shpreh Hanxhinski

Mendojmë, plotësoi më tej ajo, se integrimi vertikal i angazhimeve

tona dhe qasja në një nivel tjetër arimor do të na ndihmojë të ndërtojmë njerëz të rinj, të gatshëm për tu përballuar me sfidat e ardhshme të jetës si dhe të shënojnë sukses të shumta si në planin personal dhe profesional. Me qëllim të nxitjes së konkurrencës pozitive sa i takon përmirësimin të cilësisë arsimore në Maqedoni, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) do të ketë dyert çdo herë të hapura për institucionet private, tha njeriu i parë i saj, Renata Deskovska. Ajo, shprehu kënaqësinë për inaugurimin e AHSS-së, pasi i sheh iniciativat private si kontribuuese të përmirësimit të cilësisë në sistemin arsimor. "Edhe pse sigurimi i arsimit fillor dhe të mesëm është barrë që bie mbi shtetin, në MASH janë dyert e hapura edhe për iniciativa private të cilat nënkuptojnë përmirësimin e cilësinë arsimore në Maqedoni", tha ministria. Shkollat private i kuptojmë si konkurrencë

pozitive që duhet të sjellin risi në sistemin arsimor dhe të kontribuojnë për atë që quhet cilësia arsimore. Nisur nga ajo që një prej qëllimeve të reformave në arsimin fillor dhe të mesëm është rritja e cilësisë në kemi shfrytëzuar edhe përvoja e krahasueshme pozitive dhe shpresojmë se edhe AHSS-ja do të jetë njëra prej atyre që prodhuar kuadro cilësor dhe nxënës të talentuar të cilët do ta përfaqësojnë denjësisht Maqedoninë në arenën ndërkombëtare.

Arsimi në AHSS do të jetë i integruar në sistemin arsimor vendas dhe nuk ndryshon nga arsimi katërvjeçar i mesëm në të gjithë vendin. Funkcioni i përgjithshëm arsimor i shkollës është vendosur mbi bazën e arsimit bazik, pasi që plan-programet mësimore janë të thelluara dhe voluminoze, si parrapërgatitje e domosdoshme për arsimin e lartë. Duke pasur parasysh kushtet reale që disponon, si ma-

terialet, ambientet, kuadrin e të tjerë, plan-programet mësimore në AHSS përfshijnë të gjitha lëndë të arsimit të përgjithshëm dhe zgjedhore, mësim fakultativ dhe aktivitete jashtëshkollore.

Viti shkollor në AHSS kushton 2.500 euro. Nëse pagesa bëhet njëkohësisht me regjistrimin përfitohet një zbritje prej 5 për qind e shumës (2.375 euro). Zbritja prej 5 për qind ofrohet për regjistrim të parakohshëm të vitit shkollor (deri më 30 maj), po ashtu ofrohet për anëtarë të Rotari, Lions, UACS Business Council, anëtarë të familjes së UACS & UACS Alumni, si edhe për më shumë anëtarë të familjes më të ngushtë (studentë të UAKS dhe nxënës të AHS). Pagesa e vitit shkollor mund të bëhet edhe në dy këste, ose edhe sipas opsionit më lënien e një kapari (500 euro) dhe likuidimit gjatë vitit shkollor të pjesës së mbetur të shumës (shtator-maj) me katër ose tetë këste.

Borxhlinjtë e ujit, nga 1 prilli me këste dhe pa kamata

Shkup, 23 mars - Duke filluar nga 1 prilli, të gjithë qytetarët e Shkupit që kanë borxhe të mbetura ndaj Ndërmarrjes Publike "Ujësjellësi", do të mund t'i paguajnë faturat e mbetura të ujit me këste dhe pa kamata. Ky është vendimi i fundit që ditë më parë e miratoi Bordi Udhëheqës i NP "Ujësjellësi" nga Shkupi. Në kumtesën "Ujësjellësit" thuhet se më qëllim që t'ju dalin në ndihmë qytetarëve që me vite, për shkak të gjendjes së tyre të rëndë financiare, nuk kanë pasur mundësi të paguajnë borxhet e mbetura, tani ata do të kenë mundësi ta bëjnë pagesën e borxhit të mbetur me këste. Nga vlera totale e borxhit do të varet edhe dinamika e pagesës me këste, kështu që nëse borxhi ka vlerën prej 4000 deri më 7000 denarë, atëherë pagesa e borxhit mund të bëhet në dy këste, në tre këste do të mund të paguhet faturat prej 7000 deri më 10.000 denarë, ndërsa borxhi i mbetur që tejkalon vlerën mbi 110.000 denarë do të mund të paguhet në afat prej 2 viteve. Për borxhin total të mbetur që ngarkohet qytetari, nëse nga 1 prilli do të nënshkruan marrëveshje me NP "Ujësjellësi" se për të paguar më këste, nga dita që do të nënshkruhet marrëveshja, nuk do të ketë asnjë kamata shtesë deri sa qytetari nuk e paguan borxhin e mbetur për vlerën e cila është arritur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes. Mundësi për të paguar borxhet e mbetura në këste e kanë edhe kompanitë nga sektori privat i biznesit, por jo edhe organet dhe institucionet shtetërore, pushteti lokal si dhe ndërmarrjet publike. (Z.V)

SHTOHET NUMRI I DOKTORËVE DHE MAGJISTRAVE

Shkup, 23 mars - Hulumtimet e fundit të Entit Shtetëror të Statistikës së Maqedonisë (ESHSM), flasin për rritje të numrit të doktorantëve dhe ulje të numrit të magjistrave dhe specialistëve për vitin 2017, në krahasim me vitin paraprak 2016. Sipas ESHS, vitin e kaluar (2017), thirrjen shkencore doktor shkencash e kanë arritur 209 persona, që paraqet rritje për 6.1% në krahasim me vitin 2016, thirrjen magjistrësh shkencë dhe specialist e kanë arritur

gjithsej 1977 persona nga të cilët 1851 ose 93.6% janë magjistra dhe 126 ose 6.4% janë specialist. Derisa numri i doktorëve të shkencave në krahasim me vitin 2016 ka shënuar rritje, numri i magjistrave ose specialistëve, në krahasim me vitin 2016 është ulur për 2.2%. Numri më i madh i personave kanë doktoruar në shkenca shoqërore, edhe atë 47.8%, vijojnë shkencat mjekësore me pjesëmarrje 22%, ato humane me 11.5%, ndërsa personat tjerë

kanë doktoruar në shkencat teknologjik-teknike, matematiko-natyrore dhe bioteknike.

Hulumtimi vë në pah se numri më i madh i personave që kanë doktoruar, magjistruar e specializuar janë femra. "Numri i femrave që kanë doktoruar gjatë vitit të kaluar ka qenë 123, ose 58.9% nga numri i përgjithshëm i doktorantëve të vitit 2017. Numri i grave që kanë magjistruar nga numri i përgjithshëm i personave që kanë arritur këtë ti-

tull në vitin 2017 paraqet 58.5%", citohet në raport. Ndërkohë, rritet numri i personave të kualifikuar që janë pa punë. Edhe pse përqindja e papunësisë në mënyrë të vazhdueshme ulet, rritet numri i doktorëve të shkencave dhe magjistrave që presin punë. Të dhënat e Agjencisë për punësim tregojnë se në tregun e punës për momentin punë kërkojnë 33 doktor shkencash dhe 919 magjistra. Mbi 12 mijë persona nga numri i përgjithshëm i persona-

ve pa punë në Maqedoni janë me fakultet, derisa 1653 janë me shkollë të lartë. Sipas Agjencisë për punësim për momentin në tregun e punës ka 7.180 vende të lira pune, ndërsa më së shumti kërkohen pastues, shitës, punëtorë të thjeshtë dhe kamerier, ndërkohë që përqindja e papunësisë në Maqedoni në kuartalin e tretë vitin e kaluar ka rënë në 22.1%, përkatësisht 211.363 persona të Maqedonisë janë ende pa punë. (A.Xh)

Çanakale/Galipoli

Nga
Daut DAUTI



Kush nga gjeneratat që kanë jetuar në sistemin e kaluar nuk e ka dëgjuar këngën "Çanakale" të Hashim Shalës e Tahir Drenicës. "Çanakale mrena u nisa prej Stambollit...". Ajo këngë që e kam dëgjuar si nxënës "në kohën e gramfonëve", më kishte shtyrë të pyes veten përse rapsodët shqiptarë t'i këndojnë Çanakalës. Nuk më kujtohet ta kishim mësuar në lëndën e historisë në kontekst të Luftës së Parë Botërore, se kur kishte ndodhur beteja e Çanakalës. Në mbamendjen e dëgjuesit jo fort të arsimuar, sigurisht ishte fiksuar një betejë përgjakshme, atje diku nga Turqia. Kaq.

Shumë vjet më vonë, pata shkuar një film mbresëlënës të regjisorit australian, Piter Vir (Peter Weir), ku në rolin kryesor ishte ylli i sapolindur kinematografik që u bë i famshëm me "Mad Max-in" futuristik, Mel Gibson. Por filmi "Galipole" ku ai luajti s'kishte të bënte me ardhmërinë, por me të kaluarën! Në atë film flitej për dy sportistë australianë (të luajtur në mënyrë të shkëlqyer nga aktorët Mel Gibson dhe Mark Li), të cilët e ndjejnë si obligim patriotik të paraqiten vullnetarisht për luftën që as ata nuk e dinin tamam se ku zhvillohet. Po çfarë detyre patriotike për dy australianë që të luftojnë në një front euroaziatikafrikan (odiseada e shkuarjes së tyre)?! Duke përcjellë fatin e këtyre dy ushtarëve, të cilët bëhen korrierë në vijat e frontit, të përshatshëm për këtë gjë pasi janë

sprinterë, porosia kryesore që jep filmi është "për çka u flijuan ushtarët australianë", më saktë "gjersa australianët vdisnin në front, anglezët pinin çaj në çadra". Ky është konteksti i filmit, në të cilin gjithë rrëfimi bëhet në vijën e pasme të frontit, atë të flijimit të ushtarëve australianë si pjesë e Mbretërisë së Bashkuar Britanike. Ushtarët turq këtu janë vetëm si pjesë kontekstuale e rrëfimit, regjisorin me ta në planin e strategjisë luftarake nuk merret pothuajse aspak, sepse kjo nuk e intereson, pasi ai mëton ta japë një këndvështrim artistik, ndoshta edhe nga një këndvështrim bashkëkohor australian ndaj kësaj ngjarjeje historike.

Duke shikuar filmin, diku në fillim të viteve 80-të, në asnjë moment nuk më kishte shkuar ndërmend se "Galipole" i Piter Virit fliste për të njëjtën ngjarje si ajo e këngës së Hashim Shalës e Tahir Drenicës. Gjegjësisht, se Galipoli është Çanakaleja. Në mungesë të informacioneve dhe interesimit, Çanakaleja më kishte asocuar në një betejë për pushtimin e një kalaje, e jo në një front të madh ku beteja zhvillohet në det dhe në tokë. Plus kësaj, nuk e dija momentin më interesant për një publik shqiptar, se këtu kanë luftuar mijëra shqiptarë. Këtu e gjej edhe motivin përse Hashim Shala me Tahir Drenicën t'i kenë kënduar qemoti (ndërkohë, nga shumë versione, më pëlqen ai i vëllezërve Jashar dhe Idajet Sejdiu), ndonëse nga një hulumtim i vogël, më del

se ajo këngë edhe nuk është origjinale, por këngë turke. Shumë më vonë, viteve të fundit, nga shumë tekste historianësh e emisionesh dokumentare, më është bërë e qartë se në atë kasaphane të madhe, i kanë lënë eshtrat e tyre shumë shqiptarë. Në një këngë tjetër, ajo për Osman pashën legjendar, që në kushte mbinjerëzore i kishte bërë ballë ushtrisë ruse në Plevne të Bullgarisë, që i këndojnë vëllezërit Dervishi, e ku përmendet se "dy tabore i kam shqiptarë", ku është e qartë se është fjala për periudhën osmane para se të pavarësohej Shqipëria, në Çanakala çështja qëndron ndryshe. Shteti shqiptar tashmë ishte krijuar, kurse beteja e Çanakalës që kishte zgjatur diç më shumë se dhjetë muaj, kishte ndodhur tri vjet pas krijimit të shtetit shqiptar, ndërsa si në rrallë betejë tjetër në trollin shqiptar atë kohë, në Çanakala, përmendet një numër prej mbi 30 mijë ushtarësh shqiptarë! Gjithsesi, fakti për këtë pjesëmarrje kaq masovike të shqiptarëve jashtë trojeve shqiptare, është për analizë të kontekstit historik të kohës por dhe vetëdijësor e sociologjik. Shtetit turk e ka përjetësuar pjesëmarrjen e shqiptarëve, duke vënë në pllakat e varrit emrat e qyteteve prej nga kanë ardhur (Shkup, Prizren, Ohër, Gjakovë, Tetovë, Preshevë, Prishtinë...). Por, pyetja mbetet e hapur për motivin ose rrethanat e kësaj pjesëmarrjeje. Historiani Dr. Nebi Dervishi para disa vitesh kishte shkruar edhe këtë: "Përgjigjen e

Akti i flijimit të shqiptarëve në Çanakala dhe ai i ushtarëve turq dhe Hasan Riza Pashës për mbrojtjen e Shkodrës, mund të mos duken të logjikshme, se as shqiptarët luftuan në Çanakala për Shqipëri, as gjeneral Hasan Riza Pasha për Perandorinë e tij, por ato fundja janë një akt solidariteti e flijimi për një kauzë të drejtë



gjejmë në vargjet e Çajupit: „O shqiptarë të gjorë, ç'ju ka marrë koha erë, Derdhim gjakun për të tjerë“, duke tërhequr paralele me pjesëmarrjen masive të shqiptarëve në luftërat të udhëhequra nga Pjeter Bogdani, atë për themelimin e shtetit grek me në krye Marko Boçarin etj.

Në Çanakala është zhvilluar një nga betejat më të përgjakshme gjatë Luftës së Parë Botërore. Aty janë ndeshur afro gjysmë milioni ushtarë të forcave të Antantës (Britania e Madhe (me ushtarë britanikë si dhe nga Australia, Zelanda e Re, India...), dhe Franca) dhe 315 mijë ushtarë të Perandorisë Otomane (Turqisë në lindje e sipër), e ndihmuar nga Gjermania dhe Austro-Hungaria. Një betejë jetike për Turqinë, pasi qëllimi strategjik i forcave të Antantës ishte të merrej Stambolli dhe të hapet rruga drejt Rusisë. Në një përballje të pabarabartë, humbjet tek të dy palët kanë qenë të mëdha (afro 100 mijë të vrarë, ndonjë autor përmend mbi 200 mijë) kurse nëse i shtohet numri i të plagosurve, ai numër është trefish më i madh. Në këtë fitore të lavdishme do të vijë të Turqisë në shprehje gjenialiteti i njërit prej komandantëve kryesorë, Mustafa Qemalit, i cili edhe i kishte mobilizuar dhe komandonte ushtarët shqiptarë, prej të cilëve edhe shumë në moshë fare të re. Mustafa Qemali e kishte hetuar shumë më herët qëllimin e forcave të Antantës dhe kishte kërkuar leje nga Porta e Madhe që të ndër-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhesh, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 23 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 403000802272

merr aksion parandalues. Ky aksion u zhvillua më 18 mars 1915 me sulmin mbi anijet e ushtrisë pushtuese dhe kjo ditë shënohet si dita e fitores, ndonëse Beteja e Çanakales ende s'kishte filluar mirë, sepse zyrtarisht konsiderohet se ka zgjatur nga 17 shkurti 1915 gjer më 9 janar 1916 (në literaturën historike haset edhe periudha tjetër: 25 prill 1915-9 janar 1916).

Refleksi artistik në filmin "Galipoli", gjithsesi të shtyn të bësh analogjinë e pjesëmarrjas së australianeve në një kauzë "madhore" të kotë, (kundrejt një kauze legjitime për të mbrojtur tokën dhe sovranitetin e shtetit të vet), me pjesëmarrjen e shqiptarëve, një kauzë që duket sikur nuk është e tyre. Sepse, zyrtarisht, një shtet i pakonsoliduar, siç ishte Shqipëria, nuk mori pjesë në Luftën e Parë botërore dhe zyrtarisht nuk ishte me asnjërin prej blloqeve të konfrontuara. Një shtet që e kishte problem të mobilizojë ndonjë ushtri respektabile për të mbrojtur territorin e vet "poroz" nga serbët, grekët, malazezët, s'kishte si të mobilizojë njësi të veta të organizuara për t'i ndihmuar Turqisë, prandaj çudit numri kaq i madh i shqiptarëve që iu bashkëngjitën forcave turke në Dardanele. A shkuan ata vullnetarisht apo u mobilizuan me pagesë, apo cili ishte motivi i tyre, është çështje që fundja mund të mos ketë ndonjë domethënie në ditët e sodit. Ndoshta përgjigja qëndron edhe në supozimin se një pjesë e madhe kanë qenë shqiptarë që kanë jetuar në Turqi. Gjithsesi, është një fakt i çuditshëm dhe me shumë pikëpyetje, por mahnitës në kontekst të kohës, i cili mund të krahasohet me mbrojtjen e Shkodrës nga ana e garnizonit turk në vitet 1912-1913.

Në krye të atij garnizoni ishte Hasan Riza Pasha, një otoman me origjinë nga Bagdadi, i cili në vend se të tërhiqej, pasi Perandoria Osmane tashmë ishte larguar nga Ballkani, ai vendos ta mbrojë Shkodrën gjatë rrethimit malazez ku dhe në janar të vitit 1913 vritet (duket në një nga vetë shqiptarët), që Shkodra të mos bie në duart e ushtrisë malazeze, por t'ia dorëzojë Qeverisë së Vlorës. Ky akt flijimi i ushtarëve turq dhe Hasan Riza Pashës dhe ai i shqiptarëve në Çanakala, mund të mos duken të logjikshme, se as shqiptarët luftuan në Çanakala për Shqipëri, as gjeneral Hasan Riza Pasha për Perandorinë e tij, por ato janë admiruese, se janë akt solidariteti e flijimi për një kauzë të drejtë. Ja, që historia njeh dhe këso situatash.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Patriotizmi modern

Çfarë është ky Patriotizëm që ka pushtuar Maqedoninë?! Skena patetike të grave që shtrihen në tokë duke përjetuar kriza të mirëfillta historike vetëm sepse bëhet përpjekje ligjore për të mbrojtur një gjuhë që nuk është e saja, reagime patetike duke djegur flamuj në mënyrë të turpshme spektakulare...dëshira e çmendur e disa individëve për të shuar ekzistencën e një kombi të tërë...Gjykime të Padrejta me Verdikte të padrejta për shkak të paragjykitimit patologjik etnik...

Kërcënimi patetik në foltoren e Parlamentit i një ish-Kryeministri që ka rreth një vit që është larguar nga detyra, e pikërisht ky njeri ka përfaqësuar edhe shqiptarët, a madje ka bashkëqeverisur me shqiptarët, ky njeri që u soll kaq egërsisht ditën që do të miratohej ligji për gjuhën shqipe...

Po populli? Shumica dërrmuese e tij, si shqiptarë, si maqedonas, si turq, si bullgarë, si të gjithë, çfarë bën?! Duke rënë në grackën e gjoja garës etnike nga politikat e deritanishme është përditë edhe më i varfër! Përditë bëhet më e vështirë të paguash taksat, më e vështirë të paguash faturat e ujit dhe të energjisë, më e vështirë të paguash barnat, rritjen e fëmijëve, si përfundim është bërë e vështirë të jetosh në Maqedoni!

Një etni gjendet në mbijetesën e dinjitetit kombëtar, pasi është gjendur përballë një klase politike udhëheqëse që e ka diskriminuar sistematikisht! Shqiptarët kanë qenë gjithnjë "armiqtë" për pushtetin! Janë trajtuar si inferiorë duke u mbajtur larg nga të gjitha të mirat e një shteti që kujdeset për qytetarët e tij! Dhe politika e mbrapshtë shoviniste ia ka arritur qëllimit duke shkaktuar tek shqiptarët ndjenjën e Viktimës pasi të tillë kanë qenë dhe janë! Viktima gjithnjë të politikës që mund t'i marrë dhe më qafë si do thoshte Faik Konica në kohë të tij, madje fatkeqësisht politika të mbrapshta që tashmë udhëhiqen nga shqiptarë...

Maqedonasit nga ana tjetër kanë 500 halle ekonomike, dhe atyre po ju ikin djemtë e bijat jashtë, dhe ata janë të lodhur nga gracka shoviniste që i futi një politikë e cila udhëhiqej nga njerëz që kanë nga 4-5 xhiro llogari bankare e ndërkohë ata (populli maqedonas) mundohen të përballojnë jetën në kushte mbijetese!

Mania për pushtet ka viktimizuar një popull të tërë! Për intere-

sa perverse të një numri të vogël njerëzish (qeveritarët), shqiptarët kanë paguar dhe paguajnë me gjak, varfëri, denigrim, diskriminim, gjenocid, gjykime të padrejta aq sa Faik Konica tingëllon aktual më shumë se kurrë kur thotë: "Drejhtësia i takon fushës së ëndrrave; vetëm forca mbisundon"...vetëm se shqiptari fisnik Konica e thoshte këtë citat të dhimbshëm në vitin 1898, nuk besoj se do e besonte që shprehja e tij do gjente vend edhe në 2018, plot 120 vjet më pas! Dramatike sa shumë kemi lejuar të pësojmë!

Edhe maqedonasit janë lodhur! Janë lodhur duke u mashtruar me suksese perfide! Synimet që politikanët iu vinin përpara ishin: le t'i shtypim shqiptarët! Le t'i varfërojmë! Le t'i diskriminojmë! Shqiptarët janë vrasës! Të udhëhequr nga kjo politikë shoviniste, iluzive, mashtruese, populli maqedonas duhej të trashëgonte për fat të keq urrejtjen krejt të forcuar ndaj shqiptarëve! Çfarë fitoi?! Asgjë! Humbi dhe humbet! Mijëra maqedonas të ndershëm kishin dhe kanë fatkeqësinë të përfaqësohen nga politika agresive, të turpërohen në sy të botës duke u shfaqur si kriminelë, ndërkohë që sigurisht ata nuk kanë lidhje me veprimet e një grupi mafiozësh që për orekse të tyre politike shkelin integritetin e çdokujt, pa kursyer as shqiptarët, as turqit dhe padyshim as maqedonasit!

Etnitë që jetojnë në këtë shtet janë kuptuar gjithnjë si marioneta me role të paramenduara! Përfundimi është që të gjitha palët duan të braktisin shtetin e tyre! Drita në

Ksenofobia, as që ishte pjesë e natyrës së patriotit. Ashpërsia dhe poshtërsia s'kanë si të jenë detyra patriotike. E megjithatë, gjithkush është i lirë të dojë a të urrejë, ose thjesht të jetë moskokëçarës... Ka të drejtë Konica, kemi të drejtë e detyrë të ndjekim fjalët e tij, e Zoti mos dhëntë të jemi moskokëçarës se do na kushtojë shumë më shtrenjtë nga ç'mendojmë!



fund të tunelit po zbehet gjithnjë e më shumë! Flamuj që digjen nuk po sjellin dot asnjë denar më shumë në xhepat e popullit! Të lodhur nga pseudo-patriotizmi njerëzit kanë nevojë për Patriotizmin e vërtetë që është: një shtet që e duam sepse na do! Patriotizmi i vërtetë është përmirësim sa më urgjent i kushteve ekonomike, Edukim dhe Arsimim sa më i kualifikuar, Shëndetësi që parandalon dhe kujdeset për shtetasit me humanizëm dhe dedikim, Drejtësi të Pavarur dhe të painfektuar nga korrupsioni e aq më shumë nga histeria! Këto do ishin hapat e një shteti që kujdeset, kjo do ishte një politikë Patriotike. Sërisht do citoj Faik Konicën pasi një pjesë e mirë e politikës amerikane e ka marrë për shembull shqiptarin e zgjuar dhe më duket se ne kemi nevojë për fjalët e tij, Konica do të thoshte: "Botëkuptimi i një patrioti të vërtetë: të ngjallësh tek kombit tënd – me shijen e mendimit intelektual dhe me ndjenjë të fuqishme dinjiteti kombëtar – dëshirën e zjarrtë për përparimin e shoqërisë në kuptimin e plotë të fjalës".

Ksenofobia, as që ishte pjesë e natyrës së patriotit. Ashpërsia dhe poshtërsia s'kanë si të jenë detyra patriotike. E megjithatë, gjithkush është i lirë të dojë a të urrejë, ose thjesht të jetë moskokëçarës... Ka të drejtë Konica, kemi të drejtë e detyrë të ndjekim fjalët e tij, e Zoti mos dhëntë të jemi moskokëçarës se do na kushtojë shumë më shtrenjtë nga ç'mendojmë!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)




Nga
Arben TARA VARI



FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Koritë
5. Këngëtari anglez, Solo
7. Kufi (vjet.)
9. Fëmijë nga zezaku dhe i bardhi
10. Shtresa e ndritshme e guaskave
12. Sëmundje, rritje e tepërt e indeve të një organi
13. E punoj me limë
15. Mëzat (krahin.)
16. Të shkuarit në haxh për dikë tjetër
18. Shok (frengj.)
20. Këngëtarja Tarifa
23. Titull osman
24. I dërguari
26. Banor i Milanos
28. Vegël bujqësore
29. Lumë në Pakistan
30. Kartelet e celularëve
31. Randevu
33. Hit i grupit "Kalçër klab"
41. Emri i këngëtares sonë në foto
42. Që buron nga nëntoka
43. Ekip, skuadër
44. Perëndesha balltike e fatit
47. Prapa
48. Tempull budist në Tokio
49. Mercenar në japoninë feudale.




VERTIKALISHT


1. Rrugë që hapet në kodër
2. Malësor
3. Dru pylli i lartë
4. Marrëveshje
5. Mbiemri i këngëtares në foto
8. Bakër
9. Ndarës dhomash
11. Frikë patologjike
12. Filozofi nga Mileti
14. Jemeni
15. Sporti i bardhë
17. Vijë kufiri midis dy shteteve fqinje
18. Zbardhja e ditës
19. Skenaristi kosovar, Agim
21. Mashkulli i deles
22. Regjisori Haçaturian
23. Americiumi
24. Kompjuteri i parë
25. Itriumi
27. Aktore amerikane
30. Kompozitori çek, Bedzhih
32. Përemër pronor
33. Shtresë
34. Mahi e çatisë
35. Vijë e hapur nga ujërat e shirave
36. Lloj cigaresh
37. Lesoto
38. Kauboji i njohur, Vajat
39. Aktori egjiptas, Sharif
40. Sureja e fundit
45. Regjisori Koci
46. Axha.

Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë



KOHA e lirë për më të rinjtë


FSHEHËSIRA

Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?



DALLIMET

Cilët janë 10 dallimet në fotografitë e mëposhtme!




LABIRINTI

Ndihmoni puiës të arrijë deri te zogju!


ZBULIMI

Ngjyrosni trekëndëshat që të zbuloni figurën!



VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!





KONKURS

PËR NDARJEN E GRANTEVE PËR ORGANIZATA CIVILE, GRUPE JOFORMALE DHE MEDIA LOKALE

Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni (FShHM) shpall konkurs për ndarjen e granteve për aktorët civil lokal në Prilep, Tetovë, Strugë, Strumicë, Shkup, Kumanovë dhe Shtip. Projektet duhet të shkaktojnë ndryshme pozitive në qëndrimet dhe sjelljet e anëtarëve të komuniteteve, si dhe të përmirësojnë politikën dhe praktikën, demokracinë lokale dhe kohezionin shoqëror.

Me këtë konkurs do të ndahen tre lloje të granteve, si vijon:

1. Mbështetja e iniciativave për rritjen e angazhimit të komunitetit

Ky lloj i granteve është i dedikuar për projekte të cilat do të kontribuojnë në drejtim të rritjes së angazhimit të komuniteteve për zgjidhjen e çështjeve dhe sfidave aktuale në komunitet, të cilat janë rezultat i nivelit të ulët të kohezionit shoqëror. Bartës i projektit mund të jetë organizatë civile ose grup joformal nga rajonet e lartpërmendura. Fondi i përgjithshëm për mbështetje për vitin 2018 është 80.000 dollarë amerikan, ndërkaq shuma **maksimale e grantit për një projekt është 6.000 dollarë amerikan.**

2. Mbështetje e nismave për rritjen e solidaritetit gjatë adresimit të çështjeve me interes të përbashkët

Ky lloj i granteve, është i dedikuar për projekte nëpërmjet të cilave do të krijohen mundësi për shkëmbimin e dijeve ndërmjet aktorëve civil lokal, promovimin e praktikave të mira të ndërtimit të besimit dhe rritjen e solidaritetit gjatë adresimit të çështjeve me interes të përbashkët nga dy rajone të ndryshme. Projektet mund të parashikojnë inicimin e nismave të përbashkëta me të cilat do të kontribuohet për tejkalimin e polarizimit të brendshëm dhe ndër – etnik dhe do të promovohet kohezioni shoqëror. Projektet duhet të realizohen në partneritet ndërmjet organizatave civile dhe grupeve joformale nga të paktën dy rajone të lartpërmendura. Fondi i përgjithshëm për mbështetje për vitin 2018 është 49.000 dollarë amerikan, ndërkaq **shuma maksimale e grantit për një projekt është 10.000 dollarë amerikan.**

3. Mbështetje për krijimin e përmbajtjeve në media lokale

Ky lloj i granteve, është i dedikuar për projekte të cilat do të mundësojnë pasurimin e produksionit programor me përmbajtje të cilat do të promovojnë interesin publik, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve gjatë vendimmarrjes dhe krijimit të politikave dhe avancimin e kohezionit shoqëror në rajonet e lartpërmendura. Bartës i projektit mund të jetë media lokale / rajonale. Fondi i përgjithshëm për mbështetje për vitin 2018 është 28.000 dollarë amerikan, ndërkaq **shuma maksimale e grantit për një projekt është 7.000 dollarë amerikan.**

Përparësi gjatë përzgjedhjes do të kenë projekte inovative dhe kreative, të cilat i promovojnë vlerat e shoqërisë së hapur, tregojnë përkushtim në drejtim të përfshirjes aktive të qytetarëve dhe kanë potencial për arritjen e ndikimit të dukshëm. Projektet duhet të promovojnë qasje integruese me fokus në komunitetet, gjinia dhe personat me nevoja të posaçme.

Materialet për paraqitje janë të qasshme në www.fosm.mk. Fletëparaqitjet, së bashku me dokumentet plotësuese, duhet të parashtrihen në mënyrë elektronike, në word dhe pdf format, në adresën: solunka.zoksimovska@fosm.mk me mesazh me titull i cili përmban Emrin e organizatës / grupit joformal – titullin e projektit / nismës. Nëse keni pyetje, mund ti parashtroni në solunka.zoksimovska@fosm.mk dhe adrijana.lavchiska@fosm.mk më së voni pesë ditë para skadimit të afatit të fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve.


Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 10 prill 2018 deri në ora 16.00

(vendimet priten në fillim të muajit maj 2018).

Fletëparaqitjen e arritura pas skadimit të afateve të parashikuara nuk do të shqyrtohen. Gjatë seleksionimit të fletëparaqitjeve do të kihet kujdes të përfaqësohen organizata dhe nisma të ndryshme. FShHM e ruan të drejtën të mos ndajë mjete, nëse vlerëson se propozim – projektet nuk i plotësojnë standardet e pritshme.


SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!




MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 5.



NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



KRIPTOGRAMI



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26

MOZAIKU

2 shkronja: ESH, IT, PI, ZHK

3 shkronja: AGA, AIN, DON, IDO, TEN


4 shkronja: ANAM, ANASH, ENAI, NDESH, NDOT, NIPI, VENU

5 shkronja: ATARI, ALASI, ARKAT, ETANI, IZIDA, OZIRI, PIANO, SEKSI, ZHGANI

6 shkronja: ALESIA, EKIPOR, EVRENI, PIKASI

9 shkronja: INTERESET, MARTIN SHIN

10 shkronja: INDISPONIM, TUTANKAMON.



ARRATISET TREGTARI I MISHIT TË PRISHUR



Shmangjet Lufta tregtare BE - SHBA

Një luftë tregtare mes SHBA e BE duket të jetë shmangur për momentin. Sipas të dhënave të qeverisë amerikane, BE e partnerë të tjerë do përjashtohen nga doganat ndëshkuese për çelikun dhe aluminin që eksportojnë në SHBA. Një fitore e ndërmjetme për Europën: Në kuadër të samitit të BE vijnë lajme të mira, për krerët e BE, lajme që askush nuk guxonte t'i shprehte me zë të lartë. Tani të gjithë pranojnë se uniteti sjell fryte të mira për të gjithë. Kreu i Komisionit Euroian Jean-Claude Juncker është shprehur se "ne si Komision bëmë të qartë, se nuk duam një luftë tregtare, kjo nuk i vlen askujt, por edhe se jemi në gjendje të marrim masa adekuate." Edhe kancelarja Merkel u shpreh e lehtësuar duke theksuar se BE u prezantua në këtë çështje me unitet. "Kjo është gjë e mirë dhe një pohim për tregtinë e lirë dhe kundër proteksionizmit." Presidenti francez, Emmanuel Macron e vlerësoi përjashtimin e europianëve nga doganat ndëshkuese. "Dëshira ime është që të paktën, të vazhdojmë me rregullat e tregtisë botërore që janë të vlefshme për të gjithë ne." Por bisedimet nuk kanë për të përfunduar kaq shpejt. Ministri gjerman i Ekonomisë, Peter Altmeier pret bisedime intensive në të ardhmen. Në gjashtë javët e ardhshme kemi mundësinë që "të negociojmë shumë të përqëndruar me palën amerikane", tha ai për radion gjermane, Deutschlandfunk. Por për momentin ia kemi dalë që të shmangim një situatë të pasigurisë së madhe, tha ai. (DW)

Prokuroria e Kosovës ka filluar hetimet ndaj dy kompanive: "Beni SHPK" me bazë në Suharekë dhe "Euro IDA" me bazë në Rahovec. Kryeprokurori Shala i ka thënë Insajderit se në kompaninë "Euro IDA" janë gjetur 1 mijë e 800 kilogram me afat të skaduar

Prokuroria Themelore e Prizrenit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka bastisur lokalitë e kompanisë "Euro IDA" në Rahovec por nuk ka arritur ta arrestojë pronarin e kësaj kompanie, Anton Jupën.

"Pronari [Anton Jupa] ka ikur nga Kosova. Nuk e dimë vendndodhjen e tij, por ne kemi pasur plane për ta arrestuar", ka thënë Kryeprokurori i Prizrenit, Admir Shala.

Prokuroria e Kosovës ka filluar hetimet ndaj dy kompanive: "Beni SHPK" me bazë në Suharekë dhe "Euro IDA" me bazë në Rahovec. Kryeprokurori Shala i ka thënë Insajderit se në kompaninë "Euro IDA" janë gjetur 1 mijë e 800 kilogram me afat të skaduar.

"Kemi konfiskuar 1 mijë e 800 kilogram mish me afat të skaduar. Mishi që kemi gjetur nuk vjen nga Belgjika", ka thënë Shala.

Të hënën, Anton Jupa kërcënoi me vdekje gazetarët e Insajderit

të hënën, pasi gazeta përmes një hulumtimi të publikuar më 14 mars gjeti se kompania e drejtuar prej tij kishte importuar mish nga kompania e dyshimtë belge "Veviba". "Problemet serioze janë shumë! Shumë serioze! A me ditë qaj personi që u kon i pari, pasha natën e babës që ka dekë e ai ka bo vetëvrasje, (nuk kuptohet) s'ka me

e myt, vetëm ka me e copëtu me sakicë, ka me coptu edhe me masakru. Maje në mend qa po thom unë", kishte thënë Jupa, në një telefonatë në redaksinë e gazetës.

Drejtori i kompanisë "Euro IDA" ka pranuar se kishte importuar mish nga kompania belge në vitin 2016, ashtu siç kishte raportuar Insajderi në artikullin e publikuar më

14 mars. Zbulohet emri i kompanisë kosovare që importoi mishin nga Belgjika

Insajderi kishte siguruar një dokument nga burime brenda Doganës së Kosovës, të cilat dëshmonin se kompania "Euro IDA" kishte importuar mish nga kompania e dyshimtë belge "Veviba", në muajt maj dhe qershor të vitit 2016.

AFRO 700 TONË MISH NGA BELGJIKA NË KOSOVË

Në sofrat e kosovarëve lehtësisht ka mundur të kalojë "mish i prishur". Madje mund të ketë edhe nga ata që e kanë konsumuar këtë lloj mishi, që u eksportua nga kompania belge "VEVIBA", e cila dyshohet të ketë manipuluar me përmbajtjen e mishit dhe etiketat. Sasia e mishit që ka hyrë nga vendi që dyshohet se importoi mish të prishur, në Kosovë, në dy vitet e fundit nuk është e vogël. Vetëm në 2 vitet e kaluar dhe në tremujorin e parë të këtij viti, në vend kanë hyrë më se 633 mijë e 150 kilogram mish të llojeve të ndryshme nga Belgjika. E për tërë këta mish, qytetarët e vendit më të varfër në rajon kanë shpenzuar 467 mijë e 174 euro, shkruan Infokusi. Krejt kjo sipas statistikave të Doganave të

Kosovës. Në bazë të këtyre statistikave, viti kur nga ky vend u importuar më së shumti mish është 2016-ta. Më shumë se 276 mijë e 916 kilogram mish u importuan gjatë atij viti, në vlerë prej 244 mijë e 700 euro. Ndërsa, ky mish u përket disa llojeve. "Janë importuar mish gjedhi, pule, mish prej gjelave të detit, të tjera të brendshme nga pula e krahë të pulës", ka thënë zëdhënësi i Doganës, Adriatik Stavileci. Ndryshe, shqetësimi për përdorimin e mishit nga kosovarët është aktualizuar së fundmi. Para pak ditësh u zbulua skandali me mish të prishur e të vjetër 12 vjet e që vinte nga Belgjika, për të cilët u vërtetua se ishte destinuar për kafshë, e që nuk përjashtohet mundësia që do t'u servohej njerëzve.

Francë, pengmarrje në supermarket

Një person i armatosur ka qëlluar me armë zjarri në një supermarket në jug të Francës. Si pasojë e të shtënave një person ka humbur jetën.

Dëshmitarët shprehen se agresori thirri "Jam i ISIS" sapo hyri në supermarket, dhe më pas filloi të qëllonte.

Ai mbajti peng për disa orë klientët dhe punonjësit e një supermarketi në Trebes, të cilët u liruan, por autori vazhdon të qëndrojë i armatosur brenda supermarketit së ba-

shku me një polic. Mediat franceze shkruajnë se autori, një burrë rreth të tridhjetave kërkon të marrë hak për luftën në Siri.

Kryeministri francez, Edouard Philippe e cilësoi situatën si tepër të rëndë, duke pohuar se informacionet e deritanishme tregojnë se bëhet fjalë për një sulm terrorist. Ndërkohë policia ka rrethuar vendin e ngjarjes dhe i bën thirrje qytetarëve të shmangin zonën e rrezikut.

Hahn: Liberalizimi i vizave -pasi të luftohet krimi i organizuar

Komisioneri për fqinjësi dhe zgjerim i Bashkimit Europian, Johannes Hahn, pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ka përsëritur se liberalizimi i vizave për Kosovën vjen pas luftimit të krimit të organizuar. Hahn thotë se ka marrë konfirmim nga Thaçi se Kosova po bën pikërisht këtë gjë. "Presidenti ka konfirmuar vazhdimin e përpjekjeve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar. Kjo është mënyra më e mirë dhe më e shpejtë drejt liberalizimit të vizave për Kosovën dhe qytetarët e saj", ka shkruar Hahn në llogarinë e tij në Facebook. Hahn megjithatë e ka cilësuar takimin me Thaçin si të mirë, e votimin e demarkacionit në parlament si arritje madhore. "Takimi i mirë me Hashim Thaçin. Ratifikimi i marrëveshjes për Demarkacionin është arritje kryesore".



MINISTRIA E EKONOMISË

Ministria e ekonomisë, në pajtim me Programin për zhvillim të turizmit për vitin 2018 të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17 të datës 26.01.2018), publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për subvencionim të shtatë komunave për përpilim të Strategjive lokale për zhvillim të turizmit

- **Lëndë** e thirrjes publike – Zgjedhje e shtatë komunave për përpilim të Strategjive lokale për zhvillim të turizmit, në pajtim me Programin për punë të Ministrisë së ekonomisë.
- Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë të gjitha Komunitet e interesuara në Republikën e Maqedonisë që kanë Strategji lokale për zhvillim të turizmit ose të njëjtat që i kanë me afat të skaduar.

Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Formular (Kërkesë);
- Deklaratë se komuna nuk ka përpiluar Strategji për zhvillim të turizmit ose e njëjta është me afat të skaduar.
- Përshkrim të shkurtër të potencialeve turistike të komunës.
- Propozim buxhet për realizimin e Strategjisë për zhvillim të turizmit dhe afati për realizim të të njëjtit.

Dokumentacioni i lartpërmendur tërësisht i plotësuar parashtrohet deri në Ministrinë e ekonomisë, Sektori për turizëm dhe hoteleri.

Formularin e kërkesës për paraqitje në Thirrjen publike dhe Deklaratën, parashtrohet mund t'i sigurojnë nga arkivi ose nga ueb faqja e Ministrisë së ekonomisë www.economy.gov.mk

Kërkesat për përpilim të Strategjisë lokale për zhvillim të turizmit i shqyrton Komisioni i formuar nga ana e Ministrisë së ekonomisë.

Komisioni gjatë arritjes së të gjitha Kërkesave për subvencionim të përpilimit të Strategjive lokale për zhvillim të turizmit të parashtuara gjatë kohëzgjatjes së Shpalljes publike, me procesverbal do të përcaktojë numrin e saktë të kërkesave të arritura dhe do të përpilojë Listë të kërkuësve që kanë dokumentacion të rregulluar dhe të kompletuar i cili së bashku me Raportin e dorëzon deri në Ministrinë e ekonomisë.

Pas zgjedhjes së aplikuesve do të vijojë lidhje e marrëveshjes mes Ministrisë së ekonomisë dhe aplikuesit të zgjedhur – Komunës, me çka aplikuesi obligohet të realizojë procedurën për përpilim të Strategjisë lokale për zhvillim të turizmit për Komunitet përkatese.

Pas realizimit të përpilimit të Strategjisë lokale për zhvillim të turizmit, për të njëjtin duhet deri te Ministria e ekonomisë të parashtrohen dëshmitë financiare (marrëveshje dhe fatura) dhe kopje të strategjisë së përpiluar lokale.

Kërkesat për bashkëfinansim të Strategjisë lokale me dokumentacion të kompletuar parashtrohen deri te Arkivi i Ministrisë së ekonomisë, rr. "Jurij Gagarin" 15, Shkup deri më **23 prill 2018**.

Për informata më të hollëshme të drejtoheni në:

tel:(02) 3093 543; (02) 3093 536-faks: (02) 3093 540; e-mail: tourism@economy.gov.mk



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 15/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucion publik komunal për fëmijë - çerden e fëmijëve - Veselli Cvetovi - Dellçevë” për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102G01002 Referent i pavarur për çështje ekonomike, Shërbimi për çështje administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore, Sektori për shërbim administrativ 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, arsim ekonomik
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës:

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00
- Rroga neto: 18.515,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkates për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Komisioni për realizim të procedurës për organizim të ekskursioneve për nxënës me shpallje publike pranë Shkollës së mesme të Qytetit të Shkupit "Zef Lush Marku" – Shkup, publikon:

KËRKESË

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënësit e shkollës numër 01/2018

Ofertues: Secili subjekt juridik ose fizik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes.

Lëndë e shpalljes: Organizim të ekskursioneve përfundimtare për nxënësit e vitit të III (tretë) me kohëzgjatje prej 4 (katër) ditë me 3 (bujtje) në Durrës, Republika e Shqipërisë.

Për këtë ekskursion janë paraparë përmbajtjet në vijim:

Dita 1 SHKUP – TIRANË – DURRËS: Takimi i grupit në ora 07.30. Nisja në ora 08:00 dhe udhëtimi drejt vendkalimit kufitar Qafëthanë. Arritja në Tiranë në orët e pasdites. Vizitë panorameske dhe shëtitje nëpër qendrën e qytetit, Muzeu Kombëtar, Parlamenti, Qeveria, Pallati Mbretëror, Radiotelevizioni Kombëtar, Kështjella e Tiranës, Sahat Kulla, Sheshi Skënderbeu, Mozaiku i Tiranës, Xhamia e Etemit. Udhëtimi drejt Durrësit. Vendosi në hotel. Pushim i shkurtër. Vizita e qytetit me 3000 vjet histori. Pastaj shëtitje nëpër qytet me guidë. Vizitë të një prej Amfiteatrove më të vjetër dhe Xhamisë së Durrësit të shekullit 15. Kthimi në hotel. Darka. Disko. Bujtje.

Dita 2 DURRËS – KAVAJË – DURRËS: Mëngjes. Pas mëngjesit nisja në drejtim të Kavajës. Vizitë të bregut të Detit Jon me guidë lokal. Kohë e lirë për shëtitje dhe vizitë individuale të qytetit. Vizitë të Kishës E premija e Shenjtë e ndërtuar në vitin 1280, Ura Bukaq, Kështjella Bashov e ndërtuar në shekullin 15. Kthim në hotel. Darkë. Vizitë fakultative të diskotekës. Bujtje.

Dita 3 DURRËS – BERAT – FIER – VLORË – DURRËS: Mëngjes. Pas mëngjesit nisje për në Berat dhe vizitë të qytetit më të vjetër të Shqipërisë, i njohur ndryshe edhe si qyteti me njëmijë ditare. Pastaj vizitë në Fier, qyteti historik i periudhës së vjetër greke dhe romake me vizitë të qytetit antik – lokaliteti Apollonia. Pasdite vizitë në Vlorë, kohë të lirë për shëtitje nëpër qytet. Kthimi në hotel. Darkë. Bujtje.

Dita 4 DURRËS – SHKUP: Mëngjes. Pas mëngjesit nisje për në Shkup me vizitë pasdite në Elbasan. Kohë të lirë nëpër qytet. Nisje pasdite për në Shkup. Arritje në Shkup në orët e mbrëmjes.

Kriteret minimale për paraqitje dhe dorëzim të ofertave:

- Ofertuesi të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatese turistike;
- Të dorëzojnë dokument nga Regjistri qendror për veprimtari të regjistruar (DRD formular) dhe dokument për A licencë për kryerje të veprimtarisë turistike;
- Të dorëzojnë dëshmi se plotëson kushtet për transport të grupit të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike për makinat me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve, të bëjnë transportin me autobusë jo më të vjetër se të vitit 2005;
- Të posedojnë dëshmi për tatimet dhe kontributet e paguara ndaj shtetit, si dhe dëshmi se nuk u janë shqiptuar të gjitha llojet e ndalesave për kryerje të veprimtarisë;
- Të dorëzojnë dëshmi për kryerjen e guidëve të grupit të nxënësve të cilët mundësojnë organizim të suksesshëm dhe realizim të ekskursionit;
- Të plotësojnë të gjitha kushtet në pajtim me Rregulloren e MASH për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës për nxënësit e shkollave të mesme.

Oferta të përmbajë të dhëna për:

- Çmimi i shërbimit në të cilin do të përfshihen: transporti me autobusë turistik të pajisur me kondicionerë dhe mjete audio-vizuale, akomodim dhe ushqim në hotel me minimum 4*** në DURRËS, vizitë në Tiranë, Kavajë, Berat, Fier, Vlorë dhe Elbasan me guidë lokal, person mjekësor gjatë udhëtimit, sigurim udhëtimit, transferime të organizuara me autobusë hotel – qendër të qytetit – hotel, shoqëruar gjatë udhëtimit në secilin autobus, organizim dhe udhëheqje të udhëtimit, pemë të freskëta, lëngje dhe ujë mineral për nxënësit, bileta të paguara për të gjitha lokalitetet fakultative që do të vizitohen dhe bileta të paguara për dy diskoteka, muzikë live (shqip) për organizim të mbrëmjes solemne për nxënësit;
- Mënyra e pagesës;
- Guidë lokal, numri i mësimdhënësve dhe mjeku;
- Kushte të volitshme për nxënësit që vijnë nga familje të prekura sociale.

Kriteri për zgjedhje të ofertës më të volitshme: ÇMIMI MË I ULËT

Ekskursionet do të realizohen vetëm nëse ka numër të volitshëm të nxënësve të paraqitur.

Ofertat së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në arkivin e SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup ose vetëm me rekomandim përmes postës në adresën: rr. "Lazo Trpovski" pn, 1000 Shkup, me shenjë për Komisionin për realizim të procedurës për organizim të ekskursioneve për nxënës me shpallje publike.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të saj, gjegjësisht deri më 29.03.2018 deri në ora 10:00.

Hapja e ofertave do të realizohet në lokale të SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup më datë 29.03.2018 në ora 10:00

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Komisioni për realizim të procedurës për realizim të ekskursioneve për nxënës me shpallje publike



Nga Qerim LITA

FERHAT BEJ DRAGA, PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE TË VITEVE '30 TË SHEKULLIT TË KALUAR (2)

THEMELIMI I ORGANIZATËS STUDENTORE "BESA"

Vështirësi rreth shpërnguljes së popullsisë shqiptare, autoritetet serbo-madhe hasën edhe me Turqinë. Legata turke në Beograd, më 12 tetor të vitit 1935, përmes një note njoftonte MPJ-ë jugosllave se "gjatë këtij viti, Turqia nuk do të pranoj më emigrantë, pasi janë shterur të gjitha kreditë për vendosjen e tyre". Ky vendim i Ankaras, shkaktoi huti te jugosllavët, të cilët tashmë kishin filluar një fushatë të gjerë për pastrimin e fshatrave të tëra shqiptare

Kërkesa e mësipërme e mbretit Zog, thuhej në vazhdim të shkresës "për ne është shumë me rëndësi, sepse si duket mbreti Zog çështjes së pakicës shqiptare tek ne i ka kushtuar vëmendje të posaçme. Mbreti Zog tash përpiqet dhe dëshiron, që shqiptarët të cilët jetojnë në Kosovë e Maqedoni ta ruajnë gjuhën e tyre, të ngelin të vetëdijshëm për kombësinë e tyre, t'ua siguroj ekzistencën nacionale, me atë që në rast të ndryshimit eventual historik të ngelin si shqiptarë të vetëdijshëm. Që kjo aspiratë të arrihej, Zogu do të përpiqet që te ne të ndërpritet Reforma Agrare, të kthehet prona e konfiskuar dhe të hapen shkolla shqipe. Nëse jo shkollë, atëherë së paku nxënësve t'u ligjërohet nga një orë në ditë gjuha shqipe...". Kjo dëshirë e mbretit Zog, thuhej në fund të shkresës "edhe pse mund të ngelet vetëm si dëshirë", mirëpo, ekziston rreziku, sepse nuk duhet harruar se "të gjithë shqiptarët në Kosovë janë kompaktë" dhe nëse një ditë do të shtrohej çështja e mësipërme "do të jetë më e rrezikshme se problemi i Maqedonisë".

E një rëndësie të veçantë është për t'u theksuar fakti, se gjatë vitit 1935, diplomati i shquar shqiptar, Sheremet Xhuxhuli, sëbashku me Rauf Fiçon, i cili asaj kohe përfaqësonte Legatën shqiptare në Beograd, themeluan organizatën studentore shqiptare "BESA", në të cilën u përfshinë numri më i madh i studentëve shqiptar nga Universiteti i Beogradit dhe i Zagrebit, disa prej të cilëve më vonë luajtën rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e çështjes kombëtare, si: Shuaip Kamberi, Ibrahim Lutfiu, Nexhmedin Besimi, Esad Doko, Shaip Mustafa, Sokol Dobrosi, Tahir Ismaili, Esad Berisha, Qazim Bllaca e shumë e shumë të tjerë. Kjo organizatë, së shpejti vendosi lidhje me krahu opozitar shqiptar të BFI-së.

Gjatë atij viti, ndodhën trazira të shumta edhe brenda organeve të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, të cilat erdhën si rrjedhojë të kërkesave të vazhdueshme të krahu opozitar shqiptar, që me këtë bashkësi të udhëheqin vendorët, përkatësisht shqiptarët, e jo klika serbomadhe e instaluar nga Bosnja e Hercegovina. Në anën tjetër edhe shumica dërmuese e popullsisë boshnjake-myslimane ishte e pakënaqur me politikën e organeve të atëhershme supreme të BFI-së. Me insistimin e kryetarit të "Organizatës së Myslimanëve të Jugosllavisë", Mehmet Spaho, qeveria e Stojadinoviçit, pranoi të bëhen ndryshime radikale në organizimin e brendshëm të kësaj Bashkësie Fetare. Ndër pikat kryesore të marrë-



veshjes midis Spahos dhe Stojadinoviçit ishin: miratimi i Kushtetutës së re, kalimi i selisë së Reislul-Ulemasë nga Beogradi në Sarajevë, hapja e një medrese në Shkup (Medreseja Gazi Isa Beu) dhe organizimi i zgjedhjeve të lira.

Pas këtyre kërkesave qëndronte edhe opozita shqiptare e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, e cila autorizoi Ferhat bej Dragën, që të mbajë kontakte me Spahon. Për rrjedhojë, më 25 mars të vitit 1936, organet supreme të BFI-së, sollën Kushtetutën e re e cila hyri në fuqi me 5 nëntor të atij viti, pasi u publikua në gazetën zyrtare.

Themelimi i organizatës studentore BESA si dhe ndryshimet brenda BFI-së, gjithsesi se sollën risi pozitive në skenën politike shqiptare. Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë Jugosllave i shkruante konsullit të Përgjithshëm në Stamboll se shpërngulja e shqiptarëve në kohë të fundit po hasë në vështirësi të mëdha, për arsye se "ata (shqiptarët) dëshirojnë të shpërngulen për në Shqipëri", mirëpo Qeveria shqiptare, këtë shpërngulje është duke e penguar, duke i porositur përfaqësuesit e tyre diplomatik në Beograd e Shkup që "mos lëshojnë viza" për popullsinë shqiptare. Vështirësi rreth shpërnguljes së popullsisë shqiptare, autoritetet serbomadhe hasën edhe me Turqinë. Legata turke në Beograd, më 12 tetor

të vitit 1935, përmes një note njoftonte MPJ-ë jugosllave se "gjatë këtij viti, Turqia nuk do të pranoj më emigrantë, pasi janë shterur të gjitha kreditë për vendosjen e tyre". Ky vendim i Ankaras, shkaktoi huti te jugosllavët, të cilët tashmë kishin filluar një fushatë të gjerë për pastrimin e fshatrave të tëra shqiptare. Sa për ilustrim po i referohemi shkresës së MPJ-së jugosllave me nr. 24350/IV, dërguar Legatës së saj në Ankara, përmbajtja e së cilës është me sa vijon: "Popullsia myslimane të fshatrave Drenogllavë dhe Kërbliq, rrethi i Gjilanit, Banovina e Vardarit, ka vendos të shpërngulet nga Mbretëria jonë për në Turqi. Një pjesë më e madhe tashmë është shpërngulur, ndërsa pjesa tjetër më e vogël, rreth 110 persona, është vonuar për shkak pengesave rreth shitjes së pronës dhe rregullimit të sendeve tjera. Për çdo rast, Konsullata turke në Shkup atyre u pat premtuar t'u jep viza për t'u shpërngulur në Turqi, prandaj ata duke u bazuar në këtë i rregulluan sendet e tyre dhe përgatitën për në rrugë. Mirëpo, më 19 tetor 1935, Legata turke në Beograd, në mënyrë plotësuese njoftoi Ministrinë, se qeveritarët turk nuk janë më në gjendje t'i pranojnë as ata 110 persona nga Drenogllava dhe Kërbliqi dhe se Konsullatës së Shkupit i është lëshuar urdhëresë plotësuese që mos lëshoj viza...".

Më 19 nëntor 1935, ministri për Punë të Brendshme të R. Turqisë, Shukri Kaja, para deputetëve të Kuvendit Popullor të Turqisë, paraqiti Propozim-ligjin plotësues për kolonizim. Në ekspozenë e tij të gjatë ndër të tjerave vuri në dukje se ligji ishte i ndarë në dy pjesë, përkatësisht atë "politike dhe kulturore", për arsye se për "të parën duhet të themelohet resor i veçantë", ndërsa pjesa e dytë "do t'i besohet Ministrisë së Shëndetësisë". Përveç kësaj ai u shpreh se parashikohet "themelimi i një institucioni autonom", i cili do të merret me emigrantët dhe i cili do të ketë buxhet të veçantë. Më tej ministri theksoi se numri i përgjithshëm i refugjatëve të vendosur në Turqi arrinte shifrën prej rreth 600.000 banorëve, prej të cilëve "mbi 400.000 janë ata të cilët kanë ardh përmes shkëmbimit të popullsisë ndërsa pjesa të tjetër ka ardh me vetëdëshirë...". Nëse këto të dhëna janë të sakta, dhe nëse kësaj i shtohet se Turqia deri në atë periudhë kohore kishte arritur marrëveshje për shkëmbim të popullatës me Greqinë dhe Rumaninë, atëherë mund të arrijmë deri te konkluzioni se autoritetet jugosllave, midis harkut kohor 1918-1935, kishin arritur të shpërngulin rreth 200.000 banorë mysli-manë (shqiptarë, turq e boshnjak) për në Republikën e Turqisë.

Ky numër nuk i kënaqte apeti-



tet serbomadhe, prandaj ata bënin çmos që sa më parë të arrinin marrëveshje me qeverinë turke, që këta të fundit si duket këtë çështje nuk e kishin në plan të parë. Kjo u pa kur në pranverë të vitit 1936, u përhap lajmi për arritjen e një marrëveshjeje midis Turqisë dhe Bullgarisë, sipas së cilës autoritetet turke kishin ra dakord që brenda atij viti të pranenin 10.000 banor turq nga Bullgaria. Ky lajm shqetësoi tej mase kryeministrin jugosllav, Stojadinoviç, i cili më 24 prill 1936 përmes një letre të shifruar, kërkonte nga i deleguari i tij në Stamboll, të merr informata të detajuara përse Qeveria turke "për çështjen e njëjtë vetëm me ne e shtynë arritjen e marrëveshjes". "Po ua përkujtoj - thuhej në vazhdim të letrës - se i deleguari turk i këtushëm ka premtuar se kjo çështje do të rregullohet menjëherë pas një qershori. Ruzhdi Arasit t'ia shprehni qëndrimin tonë skajshmërisht miqësor ndaj Turqisë për të gjitha çështjet, ndërsa kjo nuk është rasti me Turqinë ndaj nesh...". Stojadinoviç nga i deleguari kërkonte që kësaj çështjeje t'i kushtoj vëmendjen më të madhe të mundshme, për arsye se siç do të shprehet "aksioni italian përmes Shqipërisë, na imponon të shpërngulim numër sa më të madh të popullsisë mysli-manë nga Jugu...".

(vijon në numrin e ardhshëm)

BOKS, KAMPIONATI EVROPIAN NË RUMANI DERI 22 VJEÇ

LAMA DHE ISMAILI SHPRESOJNË NË REZULTAT POZITIV



Ramadani synon fitoren e 10-të profesionale

Shkup, 23 mars - Më 24 mars (e shtunë) Hadis Ramadani do të përballlet me Skander Hakimi në kuadër të "Fight Night" në Folkevill të Zvicrës. Ndryshe, për kik-boksierin shqiptar ky do të jetë meçi i dhjetë profesional në VKU-Zvicër, derisa deri më tani ka nëntë fitore, me çka tani do të synojë të dhjetën. Ai deri më tani nuk është kursyer aspak dhe ka dhënë gjithçka nga vetja, kështu që disa nga luftërat që i ka zhvilluar, kanë përfunduar me ndërprerje. "Për mua ky do të jetë meçi i dhjetë. Gjithmonë kam dhënë gjithçka nga vetja për të arritur fitore. Kështu do të jetë edhe tani, ku do të tentoj të fitojë. Kundërshtari ka përvojë, i pash disa luftëra të tij, ku vërejtja se mirë punon me këmbë dhe boks", thotë kik-boksieri shkupjan. Ai thotë se ndaj Hakimi ka përgatitur një taktikë të posaçme. "Kemi taktikën tonë me trajnerin Andrej Georgiev. Shpresoj se do ta mund", përfundoi Hadis Ramadani.



Pas një pauze të gjatë, tre boksier të Maqedonisë do të marrin pjesë në një Kampionat Evropian për seniorë të rinj (U22) në Trgu Jiu të Rumanisë mha 24 marsi e deri më 2 prill. Ngjyrat e përfaqësueses së Maqedonisë do të mbrojnë tre debutues, Jasin Lama, Lulzim Ismaili dhe Goce Janeski

Shkup, 23 mars - Pas gjashtë viteve përfaqësuesja e Maqedonisë në boks do të merr pjesë në një kampionat evropian. Nga e diela në Rumania, do të nis evropiani në boks për U22, në të cilin Maqedonia do të merr pjesë me tre boksier – Jasin Lama, Lulzim Ismaili dhe Goce Janeski. Boksierët në këtë kampionat do jenë të shoqëruar nga dyshja e trajnerëve Faton Salihu dhe Petre Çurlinov. Se çfarë do të thotë kjo për ata, a janë të impresionuar nga pjesëmarrja në KE, a janë të përgatitur, çfarë presin nga ky kampionat dhe këtë vit, janë pyetjet që parashtrihen për tre boksierët e Maqedonisë. "Kjo

ka domethënie të madhe për mua, pasi caku im gjithmonë ka qenë rezultat evropian. Sigurisht, në KE, si eveniment me kualitet më të madh. Pres rezultat pozitiv, jam përgatitur mirë edhe pse jemi të vetëdijshëm se do të ballafaqohemi me boksierët më të mirë", thotë Jasin Lama, i cili ka folur edhe për planet e tij të mëtuftjesme. "Planet janë që pas KE të vazhdojë garat në kampionatin vendor dhe më pas në Shkodër në turnirin "Vllaznia". Pres që të marr pjesë në lojërat Mediterane me ndihmë të Komitetit Olimpik. Pres që ky vit të jetë viti i sukseseve", deklaroi për "ipon", Lama. Ndërsa, Lulzim

Ismaili nuk mund ti fshih emocionet para KE, por si boksier i cili gjithmonë jep më të mirën nga vetja dhe shkon deri në fund, është i bindur në rezultat solid, respektivisht do ta kalojë xhiron e parë, kurse më pas me gjitha forcat do të synojë befasinë. "Do të jap gjithçka nga vetja, sepse këtë rast e kam pritur prej moti. Jam i motivuar, posaqërisht pas përgatitjeve në Shkodër", theksoi Ismaili, i cili gjithashtu pas KE pres që të tregojë luftëra të mira edhe në kampionatin vendor dhe të sigurojë vend në Lojërat Mediterane dhe ta fitojë "Gongun e Artë". (B.K.)

Rikuperohet Berisha, Panuçi përzien kartat

Lajmi i mirë i kampit kuqezi është rikthimi në dispozicion të plotë i Etrit Berishës. Portieri i Atalantës ka kryer në ditën e pestë të përgatitjeve seancën e parë të plotë me skuadrën paradite duke marrë gjithë ngarkesën e duhur pasi disa ditë ishte stërvitur veçmas për shkak të një dëmtimi muskolor. Berisha gati për testin me Norvegjinë, mbetet për t'u parë nëse do të ndryshojë mendje Panuçi na balotazhin mes tij dhe Strakoshën, me trajnerin e Kombëtares që deri tani është shfaqur i orientuar për t'i dhënë vendin e titullarit portierit të Lacios. "Jam në një periudhë që do ta shikoj ditë pas dite. E kam një dëmtim në muskulin e kofshës. Po të jem në gjendje do mundohem të ndihmoj skuadrën. Kemi edhe disa ditë në dispozicion. Mund të them që duke filluar nga trajneri që është jashtëzakonisht i motivuar dhe mundohet ta transmetojë të ne. Jemi një ekip në zhvillim dhe kemi



treguar që jemi një grup që mund të bëjmë diçka të mira në këtë ndeshje dhe në garat e tjera. Lojtarët e rinj kanë qenë të mirëseardhur dhe shpresoj ta ndihmojnë ekipin", u shpreh Berisha. "Strakoshën e njoh edhe në kohën kur isha te Lacio. Kemi marrëdhënie jashtëzakonisht të mirë. Mundësia më e mirë për zhvillim është konkurrenca.

Porta është e garantuar me cilin do nga ne", deklaroi portieri kosovar. Ndryshe, tekniku italian ndërkohë në stërvitjen e parë të së premtës, ka përzier në një farë mënyre kartat edhe për sa i përket formacionit. Nëse një ditë më parë në ndeshjen e kontrollit ku hyrja ishte e lirë për mediat tekniku vuri në krahun e titullarëve formacio-

nin me Hysajn, Mavrajn, Gjimeshitin e Lenjanin në mbrojtje, Ramadani, përkrah Xhakës e Qakës në mesfushë dhe me Balajn me Roshin e Grezdën përpara, këtë herë Panuçi ju ka dhuruar jelekët e gjelbër 11 futbollistëve, pikërisht Mavrajt, Gjimeshitit, Ajetit, Hysajt, Xhakës, Gavazajt, Qakës, Aljijt, Bujar Likës e Grezdës si dhe Sa-

dikut. Natyrisht që nuk mund të flitet për një formacion titullar, por mund të konsiderohet si një indikacion se trajneri mund të ketë ende dyshime për sa i përket formacionit me lojtarë të caktuar që mbeten ende në balotazh në role të ndryshme. Do të luhet të hënën, dhe natyrisht që trajneri ka ende jo pak kohë për të fiksuar 11-shin titullar, ku bie në sy se janë 3 futbollistë në garë për dy vende në qendër të mbrojtjes, pikërisht Ajeti Mavraj dhe Gjimeshiti ndërkohë që në konsideratë janë edhe lojtarë si Aliji, Gavazaj apo Lika, ndërsa Sadiku mund të parakalojë Balajn. Gjatë seancës së fundit Panuçi është shfaqur veçanërisht i kujdesshëm në komunikimin me lojtarët e rinj si Qaka, Ramadani apo të tjerët e afruar kohët e fundit në kombëtare, një domosdoshmëri për ti integruar sa më shpejt me grupin, por edhe një përforsim i bindjes se ndaj Norvegjisë priten risi.



Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2018, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën aktive – Trajnim për përvetësimin e IT shkathësive, të financuar nga Banka Botërore, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën 21.01.2018, bën

THIRRJE PUBLIKE

Për personat që janë të evidentuar si të papunë, të cilët janë të interesuar të përvetësojnë aftësi nga fusha e informatikës, që të aplikojnë për pjesëmarrje në stërvitjen e njëre nga paketat programore siç vijojnë:

- ORACLE stërvitje zyrtare për JAVA SE & programmer
- ISTQB stërvitje zyrtare për testerë për cilësinë e softuerit

Këto stërvitje do ta rrisin punësimin në 100 persona dhe do të sigurojnë mundësi për të fituar aftësi profesionale dhe kualifikime për disa gjëra të caktuara të cilat kërkohen në tregun e punës.

Stërvitjet për aftësitë e përparura IT do të mbahen nga ana e zbatuesit të zgjedhur në mbarë territorin e vendit, varësisht nga interesi që do të shprehin personat që janë të evidentuar si të papunë për të marrë pjesë në masën dhe kushtet e siguruar për stërvitje, që do të thotë se stërvitjet do të mbahen në secilin regjion ku ka së paku dhjetë të paraqitur dhe me kandidatët të cilët me sukses kanë kaluar në përzgjedhjen paraprake.

Për pjesëmarrje në stërvitje, kandidati duhet t'i plotësojë kriteret siç vijojnë:

- të ketë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë
- të jetë në evidencën e të papunëve
- të plotësojë deklaratë në suaza të planit të vet individual për punësim (PIP), se dëshiron të marrë pjesë në stërvitje për aftësi të përparura IT
- personat të cilët kanë marrë pjesë në stërvitjet për aftësi të përparura IT nuk mund sërish të përfshihen në stërvitje.

Për kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të mbahet paratestimi nga ana e zbatuesit të stërvitjes, dhe vetëm kandidatët të cilët me sukses do ta kalojnë këtë testim do ta fitojnë të drejtën e pjesëmarrjes në stërvitje.

Zgjedhja e kandidatëve të cilët do të marrin pjesë, do të bëhet vetëm nga lista kandidatëve më të mirë të ranguar nga provimi kualifikues.

Lista përfundimtare e kandidatëve dhe rezultatet e fituara nga paratestimi do të botohen në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë (eë.avrm.gov.mk). Në qoftë se do të ketë numër më të madh të kandidatëve që kanë fituar pikë të njëjta gjatë paratestimit, atëherë gjatë zgjedhjes përparsi do të kenë kandidatët të cilët të parët e kanë dorëzuar fletëparaqitjen për pjesëmarrje.

Shpallja do të jetë e hapur deri në plotësimin e numrit të paraparë të kandidatëve në përputhje me këtë masë.

Stërvitjet do të mbahen në bazë të mënyrës dhe dinamikës që do ta propozojë implementuesi i trajnimit, në periudhë jo më vonë se 3 muaj nga dita e formimit të ranglistës përfundimtare duke përfshirë edhe mësimin me shfrytëzimin e literaturës zyrtare, përgatitjen e kandidatëve për certifikatë dhe realizimin e provimeve për marrjen e certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht. Të drejtat dhe obligimet e APRM, MPPS, implementuesve të trajnimit dhe pjesëmarrësve do të rregullohen me nënshkrimin e një kontrate të posaçme.

Pjesëmarrësit në stërvitje, të cilët do të ndjekin së paku 70 për qind në stërvitje, do të marrin dëftesë për ndjekjen e stërvitjes dhe do të mund ta japin provimin për marrjen e certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht.

Personat e papunë, të cilët janë të interesuar, fletëparaqitjet e tyre për pjesëmarrje mund t'i dorëzojnë në qendrën e punësimit ku janë të evidentuar si persona të papunë, çdo ditë pune prej orës 09:00 – 14:00.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, ose në telefonin kontaktues 02/ 3111-850 lokali 223 dhe ueb faqet www.avrm.gov.mk dhe www.mtsp.gov.mk.

AGJENCIA E PUNËSIMITE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS

Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçar Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

- Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 për parcelën ndërtimore 1 të pjesës nga PK 2189/2, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës.
- Prezantimi publik i DPLU do të mbahet më datë 28.03.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 10:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçar Sandevës
- Anketa publike për DPLU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Përfshirja për të cilën organizohet anketa publike dhe prezantimi publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 për parcelën ndërtimore 1 të pjesës nga PK 2189/2, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës gjendet në pjesën jugore të KK Mirkovci dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçar Sandevës, madhësia e përfshirjes është 461 m².

Dokumentet planore do të ekspozohen në lokalet e Komunës së Çuçar Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të përfshirë në afatin e paraparë mund t'i japin vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 16:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS
KRYETARI I KOMUNËS
Jovan Pejkovski

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS

Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçar Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

- Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 për parcelën ndërtimore 2 të pjesës nga PK 2189/2, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës.
- Prezantimi publik i DPLU do të mbahet më datë 28.03.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 11:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçar Sandevës
- Anketa publike për DPLU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Përfshirja për të cilën organizohet anketa publike dhe prezantimi publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 për parcelën ndërtimore 2 të pjesës nga PK 2189/2, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës gjendet në pjesën jugore të KK Mirkovci dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçar Sandevës, madhësia e përfshirjes është 1747 m².

Dokumentet planore do të ekspozohen në lokalet e Komunës së Çuçar Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të përfshirë në afatin e paraparë mund t'i japin vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 16:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS
KRYETARI I KOMUNËS
Jovan Pejkovski

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS

Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçar Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçar Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

- Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 në PK 3172, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës.
- Prezantimi publik i DPLU do të mbahet më datë 28.03.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 12:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçar Sandevës
- Anketa publike për DPLU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Përfshirja për të cilën organizohet anketa publike dhe prezantimi publik për Dokumentacionin planor lokal urbanistik për ndërtim të objektit me qëllim të vendosjes së përkohshme A4 në PK 3172, KK Mirkovci, Komuna e Çuçar Sandevës gjendet në pjesën jugore të KK Mirkovci dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçar Sandevës, madhësia e përfshirjes është 1747 m².

Dokumentet planore do të ekspozohen në lokalet e Komunës së Çuçar Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të përfshirë në afatin e paraparë mund t'i japin vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 16:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS
KRYETARI I KOMUNËS
Jovan Pejkovski

Në bazë të nenit 20 g paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005.....27/2016), nenit 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/82013.....21/18), Lajmërimin nga Ministria e financave për mjetet e siguruar financiare numër 18-2384/2 të datës 22.02.2018 dhe Vendimit për përsëritje të shpalljes publike për punësim numër 04-39/8 të datës 22.03.2018, u. d. Drejtori i IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë, publikon:

SHALLJE PUBLIKE nr. 1/2018

Për punësim të dy realizuesve për kohë të pacaktuar të punës në Institucionin publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Gonça Tufa" – Krushevë

- Emri i vendit të punës:** Rregullues të kotlave të ngrohjes – (1) realizues
-Numri rendor i vendit të punës në aktin për sistematizim të vendeve të punës: 2
-Shifra e vendit të punës: DE3 04 01 A01 003

1.1. Kushtet e përgjithshme:

- Dëshmi për shtetësi (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Vërtetim mjekësor se personi është i shëndosh psiko-fizikisht;
- Të njihë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj)
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese (jo më të vjetër se 6 muaj);

1.2. Kushtet e posaçme:

- Lloji i arsimit: Arsim të mesëm – menaxhues me kotle për ngrohje ose arsim profesional – menaxhues me kotle për ngrohje pas përfundimit të arsimit fillor;
- Përvoja e punës: pa përvojë pune

1.3 Orari i punës

- Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënë deri ditën e premte);
- Orari ditor i punës: 8 orë, prej ora 4.30 deri në ora 12.30;

1.4 Neto pagesa fillestare: 12.646,00 denarë

Vërejtje: Në pajtim me planin vjetor për punësim të IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë për vitin 2018, për këtë vend pune është paraparë punësim për (1) person nga përfaqësuesi i bashkësisë etnike shqiptare.

- Emri i vendit të punës:** Mirëmbajtës të higjienës (1) realizues

- Numri rendor i vendit të punës në aktin për sistematizim të vendeve të punës: 3
- Shifra e vendit të punës: DE3 04 01 A01 004

2.1. Kushtet e përgjithshme:

- Dëshmi për shtetësi (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Vërtetim mjekësor se personi është i shëndosh psiko-fizikisht;
- Të njihë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj)
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese (jo më të vjetër se 6 muaj);

2.2. Kushtet e përgjithshme:

- Lloji i arsimit: Arsim fillor;
- Përvoja e punës: pa përvojë pune

1.3 Orari i punës

- Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënë deri ditën e premte);
- Orari ditor i punës: 8 orë, prej ora 8.30 deri në ora 16.30;

2.4 Neto pagesa fillestare: 12.013,00 denarë

Vërejtje: Në pajtim me planin vjetor për punësim të IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë për vitin 2018, për këtë vend pune është paraparë punësim për (1) person nga përfaqësuesi i bashkësisë etnike maqedonase.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme për përbushje të kushteve të kërkuara në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, të parashtrihen përmes postës ose personalisht në arkivin e IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë në rrugën "8 Septemvri" nr – Krushevë. Telefoni për kontakt: 048/477-805.

Procedura për përzgjedhje të kandidatëve do të realizohet nga ana e komisionit tre anëtarësh për përzgjedhje në dy faza edhe atë:

- faza e parë: kontrollim të fletëparaqitjeve dhe dëshmi;
- faza e dytë: intervistë.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve: 5 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor; Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes;

IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë

Në bazë të nenit 89-a paragrafi 1 alineja 5 të Ligjit për arsim të mesëm (Fletorja zyrtare e R.M. nr. 44/1995; 24/1996; 34/1996; 35/1997; 82/1999; 29/2002; 40/2003; 42/2003; 67/2004; 55/2005; 113/2005; 35/2006; 30/2007; 49/2007; 81/2008; 92/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010; 18/2011; 42/2011; 51/2011; 6/2012; 100/2012 ; 41/2014; 116/2014; 135/2014; 10/2015; 98/2015; 145/2015; 30/2016; 127/2016 dhe 67/2017) dhe aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Gostivarit me nr. 09-1677/4 prej datës 09.02.2018, Këshilli i shkollës pranë SHMEK "Gostivar" – Gostivar në mbledhjen e mbajtur më datë 19.03.2018, solli vendimin me nr. 02-264/3 me të cilin shpall:

SHALLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJEN E DREJTORIT TË SHMEK "GOSTIVAR" - GOSTIVAR

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte të veçanta:

- T'i plotësojë kushtet për arsimtar, pedagog dhe psikolog;
- Të ketë shkollim të lartë;
- Të ketë 5 (pesë) vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor të verifikuar nga MASH;
- Të ketë dhënë provimin për drejtor;
- Të ketë dhënë testin psikologjik dhe testin e integritetit
- Të posedoj aftësi psiko- fizike dhe aftësi shëndetësore për punë

Kandidatët me fletëparaqitjen duhet ti dorëzojnë këto dokumente:

- Biografi e shkurtër;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Diplomë për kryerjen e shkollimit të lartë;
- Vërtetim për përvojën e punës në institucionet e arsimit;
- Certifikatë mjekësore (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj);
- Vërtetim/Certifikatë në momentin e përzgjedhjes të mos ketë ndonjë dënim apo ndonjë ndalesë për kryerjen e ndonjë profesioni, aktiviteti apo detyrës (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj);
- Vërtetim se nuk është i dënuar (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmi të ketë dhënë testin psikologjik dhe testin e integritetit;
- Vërtetim të provimit për Drejtor;
- Plan Program për punë në katër vitet e ardhshme.

- Orari i punës 40orë në javë edhe atë prej ditës së Hënë deri ditën e Premte prej orës 08:00deri ora 16:00.
- Rroga bazë 28.838,00den

-Shpallja publike zgjat 8 (tetë), ditë nga dita e shpalljes.

-Gjithë procedura për emërimin e drejtorit do të kryhet në afat deri më 2(dy) muaj.

- Dokumentacioni të dorëzohet original ose kopje të vërtetuara prej noteri me vulë origjinale

Dokumentacioni dorëzohet te Arkivi i Shkollës së Mesme Ekonomike Komunale "Gostivar" – Gostivar personalisht ose nëpërmjet postës në këtë adresë Shkolla e Mesme Ekonomike Komunale "Gostivar"- rr. Zhivko Brajkovski nr. 39, Gostivar.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar në kohë jo të duhur nuk do të merret në procedurë për shqyrtim dhe vendim.

Këshilli i shkollës pranë
SHMEK "Gostivar" - Gostivar

**Shitet lokal afarist në Q.T. Mavrovka me 326 m².
Çmimi sipas marrëveshjes. Kontakt telefoni 078/386 386**

Koha
www.koha.mk • WEB FAQA MË E VIZITUAR

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

Përballë merkatos së ardhshme, propozohet që të ketë një spastrim të Manchester Junajtedit. Pra, të sigurohen para nga disa shitje lojtarësh aktualë dhe të nënshkruhet me njërin nga yjet e mëdhenj. Dhe ylli më i ndritur është Nejmar, ardhmëria e të cilit të PSZH-ja nuk është fare e qartë

ZBARDHET PLANI I MURINJOS PËR TË MARRË YLLIN BRAZILIAN

MILIONA DHE POGBAN PËR NEJMARIN



Hoze Murinjo po konsideron një ofertë për Nejmarin me një shifër rekord botëror prej 260 milionë sterlina, ndoshta duke dërguar Pol Pogba të PSZH-ja si pjesë e marrëveshjes. Të paktën kështu pretendon "Diario Gol". Me yllin brazilian, me sa duket i palumtur në "Parc des Princes", trajneri i Manchester Junajtedit është i prirur për të shtuar një sulmues të klasit botëror në radhët e tij, pasi ka parë që Aleksis Sançez nuk po "ngjitet" në "Old Trafford". Ndërsa, edhe Real Madridi është i lidhur me ngushtë me Nejmarin, "Djajtë e Kuq" janë të interesuar, gjithashtu, dhe mund të dërgojnë Pogba nga ana tjetër, për ta tunduar PSZH-në në shitje. Ndërkohë, Nejmarit mund t'i ofrohen deri në 30 milionë sterlina në vit për të kaluar në "Old Trafford". Në fakt, verën e kaluar, megjithatë, kishte shumë lëvizje, por Manchester Junajted nuk kishte më shumë para për të trajtuar punësimin e një lojtari si Mbappe, apo Nejmar.

Ishte PSZH-ja, ajo që i mori ato. Murinjo u vendos për Lukaku dhe Aleksis në merkaton e dimrit, lojtarë të nivelit, por që nuk janë të thirrur për të vendosur lojërë të mëdha. Ata nuk do të zbresin në historinë e futbollit. Është pikërisht për këtë arsye që, përballë

merkatos së ardhshme, propozohet që të ketë një spastrim të Manchester Junajtedit. Pra, të sigurohen para nga disa shitje lojtarësh aktualë dhe të nënshkruhet me njërin nga yjet e mëdhenj. Dhe ylli më i ndritur është Nejmar, ardhmëria e të cilit të PSZH-ja

nuk është fare e qartë. Dihet se ylli brazilian nuk është i kënaqur në klubin e tij aktual. Dihet, gjithashtu, se dyert e Barcelonës janë mbyllur dhe se Real Madridi duket të jetë i vetmi klub, me një plan për ta kapur lojtarin brazilian për imazhin e së ardhmes.



Milan e Juve fërkojnë duart për Vilsher

Nga Anglia mbërrijnë lajme të reja në lidhje me të ardhmen e Xhek Vilsher të Arsenalit. Tabloidi britanik "Daily Mirror" i ka dedikuar një artikull të tërë mesfushorit të përfaqësueses angleze, në të cilën konfirmon se drejtuesit e Topçinjeve po e shtyn qëllimisht lojtarin drejt derës së daljes në fund të sezonit. "Tani Xhek ka frikë se Topçinjtë e detyrojnë të largohet", është titulli i përzgjedhur nga tabloidi. E përditshmja angleze raporton se Arsenal i ka propozuar Vilsher një pagë në varësi të rendimentit dhe një kontratë më të ulët se ajo aktuale, për ta shtyrë drejt largimit nga Topçinjtë. Referuar aludimeve, zëvendësuesi i tij mund të jetë Oguzhan Ozjakup, mesfushori 25-vjeçar turk, kontrata e të cilit me Beshiktashin skadon në fund të sezonit. Vilsher është shumë i kërkuar në merkato, dhe mes pretendentëve për kartonin e tij janë edhe Milani e Juventusit. Mësohet se futbollisti pretendon një angazhim sezonal për shumën e 6 milionë euro kundrejt firmës në kontratë.

Konte e Pirlo mund të drejtojnë përfaqësuesen e Italisë



Italia e ka kthyer vëmendjen tek ish-trajneri i kombëtares, Antonio Conte, që t'i drejtojë axurrët përsëri, tani drejt "Euro 2020". Me të mund të bashkohet edhe legjenda Andrea Pirlo, sipas "Gazzetta dello Sport". Të dy, Conte dhe Karlo Ançeloti, janë duke u konsideruar nga Federata Italiane e Futbollit për të marrë përsipër drejtimin e kombëtares, pasi ajo nuk u kualifikua për Kupën e Botës në Rusi. Dhe, nëse secili prej këtyre trajnerëve me famë merr frenat, Pirlo do të ishte i interesuar të bashkohej me personelin e tyre teknik. Është raportuar se Andrea Pirlo mund të

marrë një rol në organizimin e stërvitjes, edhe pse mund të varet nga fakti se kush do të jetë trajneri i ri i Italisë. Mesfushori u tërhoq në fund të vitit të kaluar, pasi kishte përfunduar kontratën në MLS, me Nju Jork Siti FC. Tani, një nga fantazistët më të mirë në botë, mund të bashkohet me stafin stërvitor në "Coverciano", pasi e fitoi Kupën e Botës me axurrët në vitin 2006. Pirlo do të jetë i lumtur të punojë së bashku me Antonio Conte, ose Karlo Ançeloti, dy nga favoritët për t'u emëruar në postin e trajnerit. Pirlo luajti 116 ndeshje me kombëtaren e Italisë, duke shënuar 13 gola.

Dua të luaj në Spanjë

Çellsit duket se do të ketë probleme me mbajtjen në ekip të Thibaut Kurtoa, i cili refuzoi të rinovonte kontratën në "Stamford Bridge" sepse dëshiron të qëndrojë pranë familjes së tij që jeton në Spanjë. Portieri nga Belgjika ka edhe 18 muaj kontratë me londinezët nga e cila përfiton 100 mijë sterlina në javë dhe klubi londinez i ofroi dyfishin e rrogës, 200 mijë sterlina, me synimin për ta mbajtur në ekip deri në vitin 2022. 25-vjeçari nuk pranoi të rinovonte, pavarësisht se po shkëlqen te Çellsit ku aktivizohet që nga viti 2011 dhe ka fituar dy herë titullin kampion. Kurtoa ka bërë me dije se po mendon të shkojë në La Liga, për të qëndruar pranë dy fëmijëve të tij të vegjël që jetojnë në Madrid. Marta Dominguez, ish-bashkëshortja e portierit, jeton në Madrid dhe pasi çifti u divorcua në muajin prill, fëmijët kanë shkuar të jetojnë me të ëmën në Madrid. Në këto kushte, edhe Kurtoa po mendon transferimin për t'i qëndruar pranë gjatë rritjes së tyre. Kalendarit i ngjeshur edhe



gjatë ditëve festive e pengon futbollistin që takojë djemtë e tij, kësaj po mendon seriozisht transferimin në La Liga, ku duket se Real Madrid e pret krahëhapur. Real Madrid është vënë në kërkim të një portieri, pasi stafi teknik ka vendosur se Kejlror Navas nuk jep më garanci për të qenë numri 1. Kurtoa dhe De Gea janë dy zgjidhet e tyre duke qenë se të dy e njohin mirë kampionatin

spanjoll ku kanë luajtur me Atletiko Madrid. Real ka kërkuar Kurtoan edhe në vitin 2015, por marrëveshja nuk u arrit sepse Çellsit kërkoi 90 milionë euro. Gjatë verës së ardhshme situata do të ndryshojë sepse londinezët do ta shesin për të mos e humbur me parametër zero në janar 2019. Xhek Butland i Stok Siti mund të jetë zëvendësuesi i tij në "Stamford Bridge".

DE BRYNE I LODHUR NGA KRAHASIMET ME MESIN DHE RONALDON

Është e pamundur t'i krahasosh Messin dhe Ronaldon me mua. Pozitat tona janë krejtësisht të ndryshme. Ata janë shumë më të lartë në fushë dhe shënojnë dhjetë herë më shumë se unë. Nëse unë shënoj 10 gola në një sezon, ata realizojnë 100. Por, pastaj, unë kam detyra të tjera në fushë", pohon belgu



Ylli i Mançester Sittit, Kevin De Bryne, është i lodhur nga krahasimet me Lionel Messin dhe Kristiano Ronaldon. "Nëse bëj 10 gola, ata shënojnë 100", shprehet De Bryne. Duke qenë një pikë referimi për udhëheqësit e Premier Ligë këtë sezon, lojtari i kombëtares së Belgjikës po tërheq shumë lëvdata. Ai tani konsiderohet të jetë një anëtar i elitës globale, me 11 gola të grumbulluar në të gjitha garat, në

sezonin 2017-2018, dhe 18 asiste të dhëna për shokët e ekipit. 26-vjeçari, megjithatë, heziton të tërhiqet në debatin sa i përket qëndrimit të tij krahas interpretuesve superstarë të Barcelonës dhe Real Madridit, me mendimin e tij se është një lojtar plotësisht i ndryshëm. Duke u krahasuar me Messin dhe Ronaldon përsëri, gjatë një angazhimi me kombëtaren, De Bryne i tha "Het Belang van Limburg". "Është e

pamundur t'i krahasosh Messin dhe Ronaldon me mua. Pozitat tona janë krejtësisht të ndryshme. Ata janë shumë më të lartë në fushë dhe shënojnë dhjetë herë më shumë se unë. Nëse unë shënoj 10 gola në një sezon, ata realizojnë 100. Por, pastaj, unë kam detyra të tjera në fushë", deklaroi belgu. Ndërkohë, trajneri i Mançester Sittit, Pep Guardiola, ka sugjeruar gjatë sezonit aktual se De Bryne është në

rrugën për t'u ngjitur në lartësi të ngjashme me Messin dhe Ronaldon. De Bryne ka qenë në gjendje të mbajë standardet e tij gjatë gjithë sezonit, pavarësisht se bëhet një objektivi i dukshëm për kundërshtarët, që përpiqen ta ndalojnë me të gjitha mënyrat. Ai, ndonjëherë, mund t'i nënshtrohet trajtimit të përafërt, por kjo është pjesë e argëtimit për një futbollist në kulmin e fuqive të tij.



Bejll thyen rekordin e Rash

Përfaqësuesja e Uellsit shkatërroi 6-0 Kinën në turneun "China Cup", ku marrin pjesë edhe Uruguai me Republikën Çeke. Më shumë se rezultati i thellë në favor të Uellsit përbën lajm fakti që 3 nga gjashtë 6 golat e skuadrës britanike i shënoi Geret Bejll, i cili hyri në histori si golashënuesi më i mirë për këtë përfaqësuese. "Ylli" i Realit të Madridit parakaloi me një finalizim më shumë Jan Rash, ish-sulmuesin e Liverpoolit dhe të Juventusit, që kur u tërhoq nga përfaqësuesja e Uellsit kishte shënuar 28 gola. "Është një arritje e madhe e cila mund të krahasohet me titujt si La Liga, "Copa del Rey" dhe Ligwn e kampionëve. Nuk e kam ëndërruar kurrë kur isha fëmijë. Është një nga gjërat më të bukura që kam arritur në karrierën time" – deklaroi i ngazëllyer Bejll.

Publicitet

"Leva" drejt Madridit

Robert Levandovski e ka shumë të qartë. Dhe ai e ka bërë të ditur vendimin e tij te Karl Hainz Rummenigge, drejtori i përgjithshëm i Bajern Muniht. Polaku dëshiron të luajë te Real Madridi dhe ka vendosur të bëjë gjithçka të mundshme për ta përmbushur dëshirën e tij. Situata duket shumë e qartë edhe për drejtuesit e udhëheqësve të Bundesligës. Po aq shumë, sa kampionët gjermanë tashmë kanë filluar kërkimin për një zëvendësues të sulmuesit polak. Timo Verner është favorit, por Bajerni nuk përjashton as mundësinë e ardhjes së mundshme të Mauricio Pochettino, që mund të sjellë me vete Harri Kin, sulmuesin e Totenhemit dhe golashënuesin më të mirë botëror në vitin 2017.

Qendërsulmuesi polak beson se koha e tij në "Allianz Arena" është afër përfundimit, ngaqë dëshira për të veshur fanellën e bardhë të Real Madridit predominon mbi gjithçka. Ai nuk ka dyshim në këtë aspekt, edhe pse e di vështirësinë e një operacioni të tillë, që nuk do të jetë i lehtë. Levandovski ka kërkuar që të jetë i sinqertë me drejtuesit e Bajern Muniht, duke iu vënë në dukje paraprakisht një situatë që nuk është e lehtë për bavarezët. Më parë, këtë javë, nga Munihi ka rrjedhur lajmi se Bajerni nuk është gati ta lërë të largohet polakun, duke kujtuar se kontrata e tij shkon deri më 30 qershor 2021. Mirëpo, drejtuesit e klubit bavarez e dinë se nuk mund ta mbajnë me zor qendërsulmuesin e tyre, ndaj kanë filluar kërkimin për një zëvendësues ideal.

Klubi nga "Bernabeu" nuk do të ketë ndonjë problem me drejtuesit e bavarezëve, ndaj kanë kontaktuar me ta, duke mohuar çdo marrëveshje me agjentin e Levandovski



(Pini Zahavi ka zëvendësuar polakun Cezary Kuçarski). Në fakt, ndryshimi i përfaqësuesit (menaxherit) ka të vetmin qëllim, që numri 9 i Bajern Muniht të largohet nga skuadra aktuale dhe t'i bashkohet Real Madridit. Pra, Zahavi nuk është një menaxher për t'u përdorur. Ai mban marrëdhënie të shkëlqyera me klube të ndryshme dhe figura e tij në futboll është shumë e konsideruar si ndërmjetës i operacioneve të komplikuar. Marrëdhëniet ndërmjet Bayernit dhe Real Madridit janë përmirësuar, pasi përjetuan momente të tensionuara pas çerekfinaleve të Ligës së Kampionëve të fundit. Largimi i Hames drejt Muniht shërbeu për të ndërtuar ura dhe hedhur themelet e një negociimi, që deri atëherë dukeshin të pamundura. Tani historia përsëritet dhe do të jenë udhëheqësit e Real Madridit, ata që duhet ta ndërmarrin hapin, kur dëshira e lojtarit duket e qartë për të kaluar në "Bernabeu".

ÇKA ËSHTË

#USHQIM
për të gjithë

FONDI PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK, NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE SHPALL THIRRJE PUBLIKE #USHQIM PËR TË GJITHË PËR PROJEKTE PËR SIPËRMARRËSI SOCIALE QËLLIMI I TË CILAVE ËSHTË QË TË NXISIN ZHVILLIM DHE ZBATIM TË ZGJIDHJEVE INOVATIVE NË SEGMENTE TË NDRYSHME TË SHOQËRISË PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË TËRËSISHËM TË JETESËS. NDRËMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME, ORGANIZATAT QYTETARE TË CILAT JANË ME PËRGJEGJËSI SOCIALE DHE/OSE KANË PËR QËLLIM QË VEPRIMTARINË E TYRE TA ZGJEROJNË NË DREJTIM TË SIPËRMARRËSISË SOCIALE FTOHEN TË PARAQITEN NË KËTË THIRRJE TË ORIENTUAR PËR GJETJE TË ZGJIDHJES SISTEMORE DHE TË QËNDRUESHME PËR SIGURIMIN E USHQIMIT PËR PERSONAT DHE FAMILJET ME NEVOJA REALE PËR MBËSHTETJE NGA BASHKËSIA DHE INSTITUCIONET.

ÇFARË ZGJIDHJE KËRKOHEN?

ZGJIDHJE INOVATIVE, GJEGJËSISHT PLATFORMË PËR MOBILIZIM TË USHQIMIT NGA TEPRICAT E TREGJEVE, DISTRIBUOMI I TU EFIKAS, ADMINISTRIM TË RRJETIT TË DEFINUAR MES PIESËMARRËSVE DHE SHFRYTËZUESVE NË PROCES, SI DHE DORËZIM DERI TEK PIKAT KU PALËT E PREKURA KANË QASJE.

PLATFORMA DUHET TË SIGUROJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME DHE SHFRYTËZIM EFIKAS TË RESURSEVE TË SHITËTIT, SI DHE SHFRYTËZIM RACIONAL TË RESURSEVE TË SEKTORIT PRIVAT, QË DERI TANI KANË PËRFUNDUAR NË MBËTURINA.

PROPOZIM PROJEKTE DUHET SISTEMATIKISHT TË OQSEN PROBLEMIT DHE TË OFROJNË METODOLOGJI INOVATIVE, E CILA DO TË ZGJIDHË ÇËSHTJEN ME SIGURIMIN E USHQIMIT DHE DORËZIMIT EFIKAS TË TU DERI TEK PERSONAT E KATEGORISË SË PREKUR.

SI TË PARAQITENI?

www.fitr.mk/obroksasite



FONDI SHPËRBLYES:

2.000.000 denarë



KORNIZA KOHORE:

23 MARS – 21 MAJ
DERI NË ORA 23:59



PËR TË GJITHA INFORMACIONET MË TË HOLLËSISHME:

MUND TË NA VIZITONI NË KONTAKT QENDRËN E FONDIT PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK NË ADRESËN RR. DIMITRIE ÇUPOVSKI NR. 8 (REKORD)

TË NA SHKRUANI NË ADRESËN ELEKTRONIKE:
obroksasite@fitr.mk

TË PARAQITENI NË NUMRIN E TELEFONIT
2 322 3373



ФОНД
ЗА ИНОВАЦИИ
И ТЕХНОЛОГИЈА



МТСП
МИНИСТЕРСТВО
ЗА ЕКОНОМСКО
РАЗВИТОК



KANADAJA HEQ TERMET "BABA" DHE "NËNË" NË FORMULARËT ZYRTARË!

Kanadaja ka vendosur që termet "baba" e "nënë" t'i zëvendësojë me termin "prindërit" në formularët zyrtarë. Ndërsa e ka ndër mend ta heqë edhe korrespondencën zyrtare të përdorimit të termeve "zonjë" e "zotëri", pos në rastet kur këtë e kërkon vetë personi. "Qeveria e Kanadasë ka vendosur të vërë gjini neutrale në të gjithë formularët e saj", ka thënë Mathieu Fillion, zëdhënës i Ministrisë së Familjes. Ky vendim është marrë

pasi që formularët e deritashëm "nuk u përshtaten rrethanave të tashme", ka sqaruar Fillion. I gjithë rasti ka filluar gjatë janarit kur një çift homoseksual në Skoci të Re desh të pajesë me dëshminë për sigurimin e fëmijës së tyre me çrast u desh të tregonin cili është babai e cili nëna e fëmijës, ka thënë zëdhënësi, përcjell Al Jazeera. Kur bëhet fjalë për korrespondencën e shkruar, Qeveria e Kanadasë atë nuk do ta fillojë më me

"Zotëri", ose "Zonjë". "Nuk ka më gjini. Letra dërgohet thjesht në emër të personit", ka thënë Fillion. Në bisedat telefonike, të punësuarit në institucionet shtetërore duhet ta fillojnë bisedën me pyetjen se si personi dëshiron t'i drejtohet, ka thënë zëdhënësi. Këto masa janë pjesë e politikës liberale të Qeverisë së kryeministrit Justin Trudeau, e cila prioritet e ka luftën për barazi gjinore në nivelin shtetëror e ndërkombëtar.

Trumpin do ta rrihja mirë me dru



Amerikanët e pakënaqur kanë gjetur mënyra të ndryshme për të treguar se nuk janë të lumtur me fjalët që përdori presidenti Donald Trump në lidhur me gratë. Në mesin e këtyre të pakënaqurve është edhe ish-zëvendëspresidenti Joe Biden, i cili në një fjalim ka thënë se do ta kishte rrahur mirë Trumpin sikur të ishin edhe një herë gjimnazistë. "Një djalë që përfundoi si lider i shtetit tonë tha 'mund ta prek një grua në çdo pjesë dhe asaj do t'i pëlqej', ka thënë Biden në një fjalim në Universitetin e Miamit, raporton ABC News. "Ata më pyetën nëse do të debatoja me këtë zotëri dhe unë u thash JO. U thash: nëse do të ishim në gjimnaz, do ta çoja prapa palestrës dhe do ta rrihja mirë dru", ka thënë Biden. "Coxha pjesë të jetës e kam kaluar në zhveshtore. Jam një atlet i mirë. Djemtë që flisin sikur ai zakonisht ishin bullafiqë dhe më të shëmtuarit në dhomë", ka kritikuar Biden. Trumpi nuk ishte i mahnitur me komentet e Bidenit dhe e përdori Twitterin për të treguar këtë. "I çmenduri Joe Biden po tenton të sillet si djalë i fortë. Ama, ai është i dobët, mentalisht dhe fizikisht, por papë më kërcënon, për të dytën herë, tani me sulm fizik", ka shkruar Trump. "Nuk më njeh, por do të rrezohej shpejt dhe fort. Duke qarë. Mos kërcëno njerëz Joe!", ka shkruar presidenti Trump për Joe Biden.



82 VJEÇARJA ME FLOKËT E SAJA I MBUSH JASTËKËT

Palestinezja Ezzeya Daraghmeh, në shtëpinë e saj brenda jastëkëve i ruan flokët e saja gati që 7 dekada. Flokët ka filluar ti ruaj që kur ka pasur 15 vjeç. Ajo ka mbushur jastëkët me flokët e saja edhe atë me shumë ngjyra, të zeza, kafe dhe të bardha. "Zoti është i madh... të

gjitha këto flokë janë nga një kokë, nga e imja", me krenari të plotë ua tha gazetarëve të Reuters. "E dua flokun tim dhe nuk dua ta hedh. Edhe kur i pres flokët apo kur i laj, i ruaj të gjitha qimet që biejnë. Kështu kam bërë gjithmonë", ka thënë 82-vjeçarja



1550 - Franca dhe Anglia nënshkruajnë Paqen e Bolonjës.

1603 - Mbreti skocez Xhejmsi VI shpallet si Mbreti Xhejmsi I i Anglisë.

1801 - Aleksandar P Romanov shpallet Perandor i Rusisë.

1837 - Kanada i jep të drejtën zakonore për të votuar.

1930 - Emërohet planeti i Plutonit

1937 - Galeria Nationale e Arteve themelohet nga ana e Kongresit.

1941 - Trupat britanike mundin Somali në.

1941 - Trupat gjermane okupojnë El Agheila në Libi.

1955 - Patrulla e ushtrisë britanike tërhiqet nga Bellfasti pas 20 viteve.

1958 - Elvis Presley fillon shërbimin ushtarak (numri serik 53310761)

1976 - Presidentja argjentinase shkarkohet nga ushtria e vendit.

1981 - Kolumbia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Kubën.

1986 - Përleshjet SHBA dhe Libi në Gjirin e Sidrës.

1999 - Lufta e Kosovës: Fillojnë bombardimet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë, duke shënuar herën e parë që NATO sulmon një shtet sovran.

Nëse ndonjëherë jeni zgjuar në mes të natës, dhe keni pirë Coca Cola, por më pas e keni pyetur veten se pse kancja e saj është ngjyrë e kuqe? Kjo zgjedhje e prodhuesve të saj, nuk ka të bëjë me Krish-tlindjet, por me taksat. Kur Coca Cola u prodhua për herë të parë në vitin 1890, ajo u shpërnda në shishe të mëdha në të gjitha dyqanet në SHBA. Pijet e gazuara asokohe tatheshin njësoj si ato alkoolike. Prandaj, u vendos që kancet dhe shisheet e Coca Cola-s të ishin të kuqe, për të bërë dallim nga pijet alkoolike.



Xhami i shkollës?

Xhoni u kthye nga shkolla në shtëpi duke qarë.

- Pse qan? - e pyet mamaja e tij.

- Më qëlloi mësuesi.

- Dhe pse të qëlloi?

- Sepse u përgjigja në një pyetje, që asnjë nxënës tjetër nuk iu përgjigj.

- Dhe çfarë pyetje ishte ajo?

- "Kush theu xhamin e shkollës!"



Leximi i librave është si të veshësh rrobat dimërore; të mbulojnë dhe të ngrohin trupin e shpirtit lakuriq.

(Munia Khan)



KALENDARI HISTORIK 24 MARS



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS